



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2019

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 11.10.2019)*

**Pika 1 e rendit të ditës me objekt:** Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave: 26.09.2019, 01.10.2019, 02.10.2019 dhe 08.10.2019.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:10 dhe mbaroi në orën 13:00.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b> | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Maksim Qoku</b>     | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Medi Bici</b>       | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Brunilda Kadi</b>   | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>6. Dritan Hallunaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Ilir Toska</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Alban Toro</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>9. Brikena Ukperaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>10. Marçela Shehu</b>  | <b>(anëtare)</b>         |

***Shënim:*** Nuk mori pjesë në mbledhje ***Erjon Muharremaj***, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtoreshë e Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
5. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
6. *Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
7. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
8. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
9. *Tahir Lamçe, OSCE.*
10. *Armand Sokoli, KSHH.*
11. *Klodian Rado, EURALIUS.*
12. *Julinda Beqiraj, EURALIUS.*
13. *Arlind Maloku, Qendra Evropiane.*
14. *Erion Fejzulla, USAID.*
15. *Ervin Karamuço, ISP.*

#### **RENDI I DITËS:**

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave: 26.09.2019, 01.10.2019, 02.10.2019 dhe 08.10.2019.

*Naureda Llagami: Përshëndetje!*

Siç jeni informuar, po fillojmë mbledhjen e datës 11 tetor 2019. Të pranishëm janë të gjithë anëtarët e Këshillit, përveç zotit Muharremaj i cili nuk është i pranishëm për arsye që ndodhet në një aktivitet duke përfaqësuar Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Atëherë, sipas rendit të ditës, sot kemi shtatë pika për shqyrtim.

Çështja e parë është: Miratimi i procesverbaleve të mbledhjes së Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave: 26 shtator, 1 tetor, 2 tetor dhe 8 tetor 2019.

Çështja e dytë lidhet me shqyrtimin e projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, si më poshtë:

- 1- “Pezullimi i procedurave të komandimit të kandidatëve gjyqtarë që kanë aplikuar për pozicionin e nëpunësit përgjegjës për vlerësimin”;
- 2- “Për komandimin e gjyqtarës {...} në pozicionin e këshilltares ligjore në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve të Këshillit të Lartë Gjyqësor”;
- 3- “Për komandimin e gjyqtarës {...} në pozicionin e këshilltares ligjore në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Projekt-akti tjetër është: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e një gjyqtari në pozicionin e Këshilltarit të Etikës pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor”. Dhe ky projekt-akt i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Projekt-akti tjetër është: Shqyrtimi i projektvendimit lidhur me “Metodologjinë për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve jogjyqtarë për në Gjykatën e Lartë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Më pas kemi shqyrtimin e kërkesës së gjyqtarës {...}, për përjashtim nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatë.

Caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatë, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet e tyre të menjëhershme.

Dhe së fundi kemi shqyrtimin e projektvendimit për verifikimin e kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për në Formimin Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, profili gjyqtar, për kandidatin: {...}, me relator z. Ilir Toska.

Jemi dakord me rendin e ditës?

Po!

Atëherë, vazhdojmë me çështjen e parë, shqyrtimin e projektvendimit për miratimin e procesverbaleve. Të gjithë jemi njohur me procesverbalet e përcjella në rrugë elektronike nga administrata e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Deri më sot nuk kemi pasur komente apo sugjerime për ndryshime apo pasaktësi. Atëherë, për rrjedhojë ju ftoj për votimin e tyre.

*Maksim Qoku*: Dakord.

*Brunilda Kadi*: Dakord.

*Dritan Hallunaj*: Pro.

*Ilir Toska:* Dakord.

*Alban Toro:* Dakord.

*Fatmira Luli:* Pro.

*Marçela Shehu:* Dakord.

*Brikena Ukperaj:* Pro.

*Medi Bici:* Pro.

*Naureda Llagami:* Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave 26.09.2019, 01.10.2019, 02.10.2019 dhe 08.10.2019. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi dhe publikimin e këtyre procesverbaleve Kryetarja e Këshillit. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 1 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.\_\_.2019

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 11.10.2019)*

**Pika 2 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, si më poshtë:

- 1- “Pezullimi i procedurave të komandimit të kandidatëve gjyqtarë që kanë aplikuar për pozicionin e nëpunësit përgjegjës për vlerësimin”;
- 2- “Për komandimin e gjyqtarës {...} në pozicionin e këshilltares ligjore në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve të Këshillit të Lartë Gjyqësor”;
- 3- “Për komandimin e gjyqtarës {...} në pozicionin e këshilltares ligjore në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:10 dhe mbaroi në orën 13:00.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                    |                   |
|--------------------|-------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare)        |
| 2. Maksim Qoku     | (zëvendëskryetar) |
| 3. Medi Bici       | (anëtar)          |
| 4. Fatmira Luli    | (anëtare)         |
| 5. Brunilda Kadi   | (anëtare)         |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar)          |

7. *Ilir Toska* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Marçela Shehu* (anëtare)

*Shënim:* Nuk mori pjesë në mbledhje *Erjon Muharremaj*, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtoreshë e Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
5. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
6. *Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
7. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
8. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
9. *Tahir Lamçe, OSCE.*
10. *Armand Sokoli, KSHH.*
11. *Klodian Rado, EURALIUS.*
12. *Julinda Beqiraj, EURALIUS.*
13. *Arlind Maloku, Qendra Evropiane.*
14. *Erion Fejzulla, USAID.*
15. *Ervin Karamuço, ISP.*

#### **RENDI I DITËS:**

2. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, si më poshtë:

- 1- “Pezullimi i procedurave të komandimit të kandidatëve gjyqtarë që kanë aplikuar për pozicionin e nëpunësit përgjegjës për vlerësimin”;
- 2- “Për komandimin e gjyqtarës {...} në pozicionin e këshilltares ligjore në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve të Këshillit të Lartë Gjyqësor”;
- 3- “Për komandimin e gjyqtarës {...} në pozicionin e këshilltares ligjore në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

**Naureda Llagami:** Kalojmë tek çështja e dytë, e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, duke filluar me projekt-aktin e parë lidhur me pezullimin e procedurave të komandimit të kandidatëve gjyqtarë që kanë aplikuar për pozicionin e nëpunësit përgjegjës për vlerësim.

Lidhur me relatimin e këtij projekt-akti ia jap fjalën kryetares së Komisionit, zonjës Ukperaj.

**Brikena Ukperaj:** Faleminderit, zonja Kryetare!

Bashkë me materialet është përgatitur një raport i detajuar i Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, i investuar tashmë në fazën e dytë të vlerësimit, sipas vendimit të miratuar nga vetë Këshilli për shpalljen e kërkesave për komandim gjyqtari në strukturat e KLGJ-së. Aktualisht, siç është relatuar edhe më parë, sepse është bërë edhe një opinion nga Komisioni i Karrierës, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka shpallur 4 vende vakante: Dy për pozicione të lira në strukturën ose Njësinë Mbështetëse të Komisioneve, në pozicionin e “këshilltarit ligjor” dhe dy të tjera pozicione të lira si “nëpunës përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik. Opinioni i Komisionit të Karrierës, i cili është votuar edhe në mbledhjen plenare është miratuar me detyrimin e Komisionit të Etikës që të vazhdojë fazën e dytë dhe të vijojë procedurat e vlerësimit vetëm për 4 kandidatura, pasi një kandidate është përjashtuar nga komandimi, për shkak të ekzistencës së një kriteri ndalues.

Në këtë kuadër, Komisioni i Etikës filloi fazën e dytë të vlerësimit, pra fazën e dytë të procedurës së komandimit, vetëm me vlerësimin e katër kandidatëve, nga të cilët dy prej tyre kishin shfaqur vullnetin për t’u komanduar vetëm në një pozicion të caktuar,

siç ishte pozicioni i “nëpunësit përgjegjës për vlerësimin” në strukturën e Njësine Mbështetëse të Komisioneve, konkretisht zonja {...} dhe zonja {...}, ndërsa dy kandidatet e tjera, gjyqtare {...} dhe {...} kishin shprehur vullnetin për t’u komanduar qoftë edhe në një nga pozicionet e shpallura, pa treguar preferencë lidhur me ndonjërin prej tyre.

Aktualisht bëj me dije se përbërja dhe statusi i punonjësve të njësise përgjegjëse për vlerësimin është në diskutim e sipër nga Këshilli për shkak se është i lidhur ngushtë me vendimmarrjen e tij lidhur me statusin e ish-inspektorëve, të cilët qoftë për shkak të trashëgimisë institucionale, ex-lege, apo deri në krijimin e ILD-së, po vazhdojnë punën e tyre pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në kushtet e mësipërme Komisioni për Vlerësimin e Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale në zbatim të nenit 61, 97, pika 3 të ligjit 115/2016 të ndryshuar, pikës 5 të nenit 54 të ligjit për Statusin, neneve 11 dhe 67 të Kodit të Procedurave Administrative, duke qenë se KLGJ ka në rastin konkret edhe cilësinë e institucionit ku kërkohet të kryhet komandimi, i propozon mbledhjes plenare (i ka propozuar) pikërisht: Pezullimin e procedurës të komandimit për dy pozicionet të shpallura si “nëpunës përgjegjës për vlerësimin” deri në përfundim të shqyrtimit të statusit të ish-inspektorëve dhe përbërjes së Njësise së Vlerësimit Profesional dhe Etik.

Ky pezullim arsyetohet me faktin sepse aktualisht sot, nëse ne do të bënim vlerësim, duhet të paraqisnim pranë Këshillit propozimin për komandim të gjyqtarëve sepse e tillë është procedura e komandimit dhe vlerësimit për t’u komanduar në njësine përgjegjëse. Në kushtet kur përbërja, statusi i inspektorëve, që aktualisht po ushtrojnë detyrën pranë kësaj njësie, është në diskutim e sipër, do të paragjykonte të gjithë numrin e strukturës dhe përbërjes së kësaj njësie. Për këtë arsye kemi propozuar – unë e përmenda shkurtimisht, më gjatë sqarohet në relacion – që procedurat e komandimit për dy gjyqtarët që kanë aplikuar për Njësine e Vlerësimit, të pezullohen.

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zonja Ukperaj!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim lidhur me propozimin që ka sjellë Komisioni?

E kalojmë në votim?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.



**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi pezullimin e procedurës së komandimit për dy pozicionet të shpallura “nëpunës përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve, deri në përfundim të shqyrtimit të statusit të ish-inspektorëve dhe përbërjes së kësaj Njësie. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë në pikën tjetër, në projekt-aktin tjetër që do marrim në shqyrtim, e cila ka të bëjë me dhënien e vlerësimit dhe komandimin e magjistratëve si këshilltarë ligjorë, që edhe ky projekt-akt është përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Për më shumë detaje, fjalën ia kaloj prapë kryetares së këtij Komisioni, zonjës Ukperaj.

**Brikena Ukperaj:** Faleminderit, zonja Kryetare!

Atëherë, në vijim po ju paraqiten të dhëna në lidhje me vlerësimin, renditjen dhe propozimet për komandim, për kandidatët që kanë aplikuar për këshilltar ligjor, gjyqtaret {...} dhe {...}. Paraprakisht bëhet e ditur që vlerësimi i tyre është bërë nga ky Komision mbi baza dokumentare, bazuar në të dhënat e dosjes personale dhe dokumentacioni i depozituar rishtazi në KLGJ nga gjyqtari bashkangjitur kërkesës për komandim, pa u vlerësuar i nevojshëm intervistomi.

Gjatë procedurës së vlerësimit Komisioni ka patur parasysh edhe kriteret preferenciale të parashikuara në vendimin nr. 104, datë 05.07.2019, sipas të cilit: Ka përparësi kandidati që plotëson këto kritere:

- a. Ka ekspertizë të veçantë në fushën e hartimit të akteve rregullatore;

- b. Ka njohuri mbi legjislacionin e vendeve të Bashkimit Evropian, mbi akte ndërkombëtare dhe mbi jurisprudencën e gjykatave ndërkombëtare, në lidhje me statusin e gjyqtarit dhe organizimin e sistemit gjyqësor.
- c. Është autor i artikujve ose botimeve shkencore në fushën e jurisprudencës.
- d. Ka njohuri të mira të paktën në një gjuhë të vendeve të Bashkimit Evropian;
- e. Ka aftësi të mira profesionale, organizative, personale, si dhe etike të lartë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale.

Lidhur me dy gjyqtaret është konstatuar që: Gjyqtare {...} ka një eksperiencë pune mbi 5 vjet e 9 muaj dhe ka gjykuar në shkallë të parë çështje të të gjitha kategorive (veç atyre administrative). Ka njohuri shumë të mira të gjuhës angleze, pasi referuar dëshmisë së gjuhës angleze të lëshuar nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, është vlerësuar me notën 5 (*lapsus, pasi është nota 8*). Nga pesë dokumentet ligjore që përmenden shprehimisht në relacion, konkludohet se ka aftësi shumë të mira profesionale. Në çdo dokument ligjor, gjyqtarja i referohet pretendimeve dhe të dhënave që janë shqyrtuar gjatë procesit gjyqësor, përmend dhe analizon bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes dhe analizon provat në drejtim të saj. Të pesë dokumentet ligjore janë të rregullt në formë dhe të qartë në përmbajtje. Pjesët e vendimit kanë lidhje dhe janë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Nuk gjen në pjesën arsyetuese kundërthënie argumentesh apo mospërputhje me pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parime dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik, kritere këto të vendosura nga vetë praktika e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë.

Nisur nga mënyra e arsyetimit të dokumenteve ligjore, pavarësisht se nga ana e Komisionit nuk është bërë vlerësim i dosjeve konkrete, konstatohet gjithashtu që gjyqtarja ka aftësi të mira organizative. Është ndjekëse e trajnimit vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës dhe atyre të organizuar nga organizata të tjera ndërkombëtare, çka tregon se ka angazhim ndaj vlerave të saj profesionale. Ka eksperiencë të tjera personale sepse në periudhën 10.07.2008 deri 04.10.2009 ka punuar gjithashtu si Specialiste e Nivelit të Lartë për Legjislacionin në Bashkinë Korçë.

Ndërkohë që, nga shqyrtimi i dokumentacionit nuk na ka rezultuar që të ketë ekspertizë në fushën e hartimit të akteve rregullatore, njohuri mbi legjislacione të vendeve të

Bashkimit Evropian, apo mbi akte ndërkombëtare dhe mbi jurisprudencën e gjykatave ndërkombëtare, akte që kanë lidhje me statusin e gjyqtarit apo organizimin e sistemit gjyqësor. Nuk rezulton që të jetë bashkautore apo autore e ndonjë artikulli apo botim shkencor në fushën e jurisprudencës.

Lidhur me gjyqtaren {...} është konstatuar se ajo ka një eksperiencë pune prej 4 vjet, mbi 4 vjet, duke gjykuar të gjitha kategoritë e çështjeve gjyqësore (veç administrative). Ka njohuri shumë të mira të gjuhës angleze, certifikuar me certifikatë TOEFL (583 pikë). Është bashkautore e dy artikujve shkencorë në fushën e jurisprudencës. Artikulli me temë: “Ankimi gjyqësor ndaj vendimit të mos fillimit/pushimit të çështjes...” botuar në revistën shkencore “Jeta Juridike” në 3 shtator 2013 dhe një botim tjetër i datës 27.04.2015 në revistën juridike italiane “diritto.it”, tema që ka lidhje me protokollin 1 të konventës dhe të drejtën e pronës në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Nga pesë dokumentet ligjore vërtetohet, për të njëjtat shkaqe që u përmend edhe më lart, aftësi e lartë e gjyqtares për sa i përket cilësive të saj profesionale.

Nisur nga mënyra e arsyetimit të dokumenteve ligjore, gjithashtu ka konstatuar Komisioni aftësi të mira organizative. Edhe kjo gjyqtare është ndjekëse e trajnimit vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës si dhe atyre të organizuara nga organizata të tjera ndërkombëtare, çka tregon se ka angazhim ndaj vlerave të saj profesionale. Ka eksperiencë të tjera personale, ka qenë pjesë e projektit për përpunimin e manualit për ligjin “Për falimentin” kontaktuar nga Assist Impact, ka qenë pedagoge e jashtme në Albanian University për lëndët “Procedurë Civile” dhe “E drejta e Falimentit” (bashkëngjitur, pjesë e dosjes personale janë edhe vendimet e ish-KLD për lejimin e mësimdhënies).

Nuk rezulton që të ketë të dhëna mbi ekspertizën në fushën e hartimit të akteve rregullatore, sipas pikave /a/ dhe /b/ të nenit 5 të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Gjithsesi, Komisioni ka vlerësuar përfundimisht se, të dy gjyqtaret shfaqin aftësi të mira profesionale, organizative, personale, etikë të lartë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale dhe zotërojnë shumë mirë gjuhën angleze. Pavarësisht se nuk kanë eksperiencë personale në draftimin e akteve rregullatore, për shkak të ushtrimit të funksionit të gjyqtarit apo edhe të veprimtarive të tjera jashtë këtij funksioni, ato shfaqin aftësi interpretuese dhe zbatuese të ligjit si dhe aftësi teknike për kërkime ligjore mbi legjislacione të vendeve të Bashkimit Evropian, akte ndërkombëtare apo jurisprudencën e gjykatave ndërkombëtare, në

lidhje me statusin e gjyqtarit dhe organizimin e sistemin gjyqësor. Nga ana tjetër referuar kriterëve preferenciale të parashikuar në piken 5 të vendimit nr. 104, nuk është vlerësuar e nevojshme nga ana e Komisionit që të bëhet një renditje e tyre, pasi në rastin konkret pozicionet e shpallura të lira për komandim janë 2 dhe të dy gjyqtarët plotësojnë kushtet dhe kriteret e komandimit.

Përfundimisht, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, në përfundim të procedurës së vlerësimit, i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor:

Komandimin e gjyqtarës {...} në pozicionin e “këshilltarit ligjor” në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve. Afati i komandimit, sipas vendimit, është 2 vjet. Kjo periudhë komandimi propozohet të fillohet në datën 21.10.2019, me qëllim që edhe gjyqtarës t’i lihet një afat i arsyeshëm për dorëzimin e dosjeve apo për përfundimin e çështjeve për të cilat është mbyllur shqyrtimi gjyqësor.

I njëjti propozim nga ana e Komisionit vjen edhe për gjyqtaren tjetër {...}. Edhe për këtë propozohet komandimi në strukturën përkatëse të Njësisë Mbështetëse të Komisioneve në KLGJ. Afati është 2 vjet edhe për këtë gjyqtare. Propozohet, për të njëjtin shkak të përmendur më lart, që edhe për të, periudha e komandimit të fillojë në datë 21.10.2019.

Gjithashtu, Komisioni ka propozuar gjithashtu, që deri në fillimin e periudhës së komandimit, të dy gjyqtaret duhet të përjashtohen nga procedurat e ndarjes së çështjeve me short në gjykatat respektive. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zonja Ukperaj!

Atëherë, kalojmë në votim lidhur me propozimin e parë, për komandimin e gjyqtarës {...} në pozicionin e këshilltarit ligjor në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve në Këshillin e Lartë Gjyqësor. Jemi dakord?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi komandimin e gjyqtares {...} në pozicionin e këshilltarit ligjor në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve në Këshillin e Lartë Gjyqësor. Periudha e komandimit është 2 vjet dhe fillon në datë 21.10.2019. Përrjashtimin e menjëhershëm të gjyqtares {...} nga procedurat e ndarjes së çështjeve gjyqësore me short në gjykatë. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë në propozimin e dytë të bërë nga ana e Komisionit lidhur me komandimin e gjyqtares {...} në pozicionin e këshilltarit ligjor pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor. Jemi dakord?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Illir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi komandimin e gjyqtares {...} në pozicionin e këshilltarit ligjor në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve në Këshillin e Lartë Gjyqësor. Periudha e komandimit është 2 vjet dhe fillon në datë 21.10.2019. Përrjashtimin e menjëhershëm të gjyqtares {...} nga procedurat e ndarjes së çështjeve gjyqësore me short në gjykatë. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 2 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2019

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 11.10.2019)*

**Pika 3 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e një gjyqtari në pozicionin e Këshilltarit të Etikës pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:10 dhe mbaroi në orën 13:00.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

*Shënim:* Nuk mori pjesë në mbledhje *Erjon Muharremaj*, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtoreshë e Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
5. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
6. *Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
7. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
8. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
9. *Tahir Lamçe, OSCE.*
10. *Armand Sokoli, KSHH.*
11. *Klodian Rado, EURALIUS.*
12. *Julinda Beqiraj, EURALIUS.*
13. *Arlind Maloku, Qendra Evropiane.*
14. *Erion Fejzulla, USAID.*
15. *Ervin Karamuço, ISP.*

#### **RENDI I DITËS:**

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e një gjyqtari në pozicionin e Këshilltarit të Etikës pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

*Naureda Llagami:* Atëherë, kalojmë tek çështja e radhës, e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit mbi caktimin e Këshilltarit të Etikës pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor. Më lejoni të them që ky është një nga vendimet më të rëndësishme që Këshilli do të marri sot, miratimi i një këshilltari për etikën nga radhët e gjyqtarëve. Këshilli është



përgjegjës si për standardet etike, ashtu edhe për respektimin e tyre. Si sjellja jonë ashtu edhe e çdo gjyqtari është po aq e rëndësishme sa edhe drejtësia që jepet në gjykata. Ky hap dhe kjo vendimmarrje do t'i hapë rrugë hartimit të rregullave dhe do të jetë garanci për zbatimin e tyre.

Për më tej ia jap fjalën zonjës Brikena Ukperaj, kryetare e Komisionit të Vlerësimit të Etikës, lidhur me propozimin përkatës.

***Brikena Ukperaj:*** Faleminderit, zonja Kryetare!

Sikundër edhe ju relatuat, detyrimi për të ruajtur e treguar etikë profesionale dhe siguruar pavarësi në nivel institucional dhe individual, është përgjegjësi personale e çdo magjistrati. Kjo përgjegjësi vlen si për jetën profesionale gjatë ushtrimit të funksionit, por edhe për jetën private të magjistratit. Në funksion të ruajtjes e forcimit të besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë, në çdo kohë magjistratët duhet të kenë një qasje profesionale dhe etike që jo vetëm është, por edhe duket si e tillë.

Dispozitat ligjore të statusit të magjistratit i ngarkojnë një rol aktiv magjistratëve, duke kërkuar nga ana e tyre marrjen e të gjitha masave për të lartësuar reputacionin e organeve të drejtësisë. Standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes për gjyqtarët miratohen dhe publikohen nga KLGJ. Konkretisht në nenin 83 të ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, parashikohet detyrimi i KLGJ për miratimin dhe publikimin e rregullave të etikës gjyqësore si dhe për mbikëqyrjen e vazhdueshme të tyre. Për shkak të rëndësisë që ka etika dhe çështjet rreth saj, në dispozitën e mësipërme është parashikuar gjithashtu caktimi i një Këshilltari për Etikën nga radhët e gjyqtarëve, i cili në rast të një ngarkese të justifikuar pune mund të shërbejë në këtë pozicion me kohë të plotë.

Këshilltari për Etikën shërben për një periudhë 5-vjeçare dhe ka të drejtë të rizgjidhet vetëm një herë në këtë pozicion. Për shkak të natyrës së detyrave që do të kryejë Këshilltari për Etikën, kriteret kualifikuese për këtë pozicion janë të larta dhe ekuivalente me kushtet ligjore që duhet të plotësojë një magjistrat për të qenë anëtar i Gjykatës së Lartë. Detyrat e Këshilltarit për Etikën konsistojnë kryesisht në këshillimin e çështjeve të diskutueshme të etikës të ngritura me kërkesë nga ana e gjyqtarëve, hartimin e përditësimit të manualeve zbatuese që orientojnë për zgjidhjen e situatave të ndryshme

kur aspekte të etikës janë të diskutueshme, ndërveprimin me Shkollën e Magjistraturës si dhe ndërveprimin me KLGJ dhe raportimin periodik përpara tij.

Pozicioni i Këshilltarit për Etikën është parashikuar në funksion të përmirësimit të standardeve etike në radhët e gjyqtarëve jo vetëm nëpërmjet ofrimit të këshillimit për gjyqtarët, por edhe ofrimit të mundësive për zbatimin uniform të rregullave të sjelljes. Këshilltari për Etikën ushtron veprimtarinë vetëm në funksion të nevojave të gjyqtarëve për këshillim dhe është i detyruar të mbajë konfidencial komunikimet me gjyqtarin. Nga ana tjetër detyra e Këshilltarit për Etikën, nuk është e lidhur me organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë që ushtrojnë funksione vlerësimi e inspektimi, madje atyre nuk u lejohej t'i japin informacion këtyre organeve. Edhe kërkesat që ai i drejton Këshillit dhe raportimet kanë për objekt raste sjelljesh dhe kombinime rrethanash që përfshijnë aspekte të etikës, por në asnjë rast nuk tregojnë të dhëna për gjyqtarin kërkues dhe/ose gjyqtarin/ subjekt të situatës për të cilën kërkohet mendim apo raportohet para tij.

Në këtë kuadër, pozicioni dhe roli i Këshilltarit për Etikën është shumë i rëndësishëm, prandaj veç kushteve të parashikuara në nenin 83 të ligjit 115/2016, gjyqtari që caktohet në këtë pozicion duhet të shfaqë vetë aftësi të shkëlqyera etike dhe morale dhe të këtë një reputacion mes kolegësh por edhe për publikun, që e bën jo vetëm të besueshëm, por i shërben edhe ngritjes së reputacionit të sistemit në vetvete.

Komisioni për Vlerësimin Etik dhe Profesional, duke marrë parasysh nevojat që ka aktualisht sistemi gjyqësor për gjyqtarë në detyrë si dhe ngarkesën aktuale të punës në Këshill, vlerëson se caktimi i një gjyqtari në pozicionin e Këshilltarit për Etikën, në këtë moment, nuk është i nevojshëm të bëhet me kohë të plotë, e për pasojë të ndiqen procedurat e komandimit për caktimin e tij. Aktualisht është vlerësuar se funksionet e Këshilltarit për Etikën mund të kryhen prej gjyqtarit që do të caktohet, paralelisht me ushtrimin e funksioneve gjyqësore.

Në nenin 83 të ligjit 115/2016 parashikohet se gjyqtari që caktohet në pozicionin e Këshilltarit për Etikën, duhet të plotësojë kushtet ligjore për të qenë anëtar i Gjykatës së Lartë. Në këtë aspekt, në referim të neneve 136 të Kushtetutës, 32, 47 dhe 48 të ligjit për Statusin, gjyqtari që caktohet në këtë pozicion, duhet të ketë jo vetëm përvojën profesionale si gjyqtar mbi 13, por duhet të ketë kaluar me sukses edhe procesin e

verifikimit të pasurisë dhe figurës. Veç kriterëve ligji parashikon gjithashtu që gjyqtari që caktohet duhet të ketë përvojë dhe njohuri mbi çështjet e etikës.

Në respektim të kushteve ligjore, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale i propozon mbledhjes plenare caktimin e gjyqtarës {...}, gjyqtare në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda, në pozicionin e Këshilltarit për Etikën në Këshillin e Lartë Gjyqësor. Ky propozim bazohet në:

Së pari, përvojën e saj profesionale si gjyqtare mbi 13 vjet. {...} është dekretuar gjyqtare në datë 15.09.2000 (është dekreti nr. 2742, datë 15.09.2000 i Presidentit të Republikës). Ajo ka ushtruar detyrën e gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan në periudhën 16.09.2000 - 28.02.2006, kohë në të cilën është dekretuar gjyqtare në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda, detyrë që e kryen ende dhe sot. Në periudhën 06.05.2011 – 06.05.2014 (për një periudhë 3-vjeçare) {...} ka qenë e komanduar në Shkollën e Magjistraturës në pozicionin e pedagogut të brendshëm.

Së dyti, {...} ka kaluar me sukses procesin e vlerësimit kalimtar pasi me vendimin nr. 135, datë 05.04.2019 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili ka marrë formë të prerë në 22.05.2019 ajo është konfirmuar në detyrë, referuar edhe rregullores së miratuar, nga momenti që ky vendim ka marrë formë të prerë, deri më sot, nuk rezulton që të kenë kaluar 180 ditë.

Së treti, ka ekspertizë në fushën e etikës, pasi ka qenë bashkautore e manualit të etikës gjyqësore të hartuar në kuadër të Unionit të Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë.

Ka një angazhim të gjerë profesional, në fusha të ndryshme të së drejtës si eksperte dhe bashkëpunëtoresh e vazhdueshme e Shkollës së Magjistraturës.

Gëzon reputacion të mirë dhe besimin e kolegëve.

Edhe diçka tjetër që nuk është përmendur në relacion. Duke qenë që askush nuk mund të detyrojë të bëjë një punë të detyrueshme, paraprakisht është folur me gjyqtaren dhe ajo ka shprehur gatishmërinë për të dhënë kontributin e saj në këtë strukturë të re të Këshillit. Mbetet për t'u vlerësuar nga mbledhja plenare caktimi i gjyqtarës.

*Naureda Llagami:* Shumë faleminderit zonja Ukperaj, lidhur me relatimin dhe propozimin konkret që kishit për Këshilltarin e Etikës, për të cilën është një hap shumë i rëndësishëm që Këshilli duhet të ndërmarrë në këtë mbledhje.

Nëse kemi diskutime ose propozime të tjera, përveç propozimit të bërë nga Komisioni përkatës, jeni të hapur për t'i bërë. Ndryshe, kalojmë në votimin e propozimit të bërë nga Komisioni.

*Maksim Qoku:* Dakord.

*Naureda Llagami:* Votim! Okej!

*Brunilda Kadi:* Dakord.

*Dritan Hallunaj:* Pro.

*Illir Toska:* Dakord.

*Alban Toro:* Dakord.

*Fatmira Luli:* Pro.

*Marçela Shehu:* Dakord.

*Brikena Ukperaj:* Pro.

*Medi Bici:* Pro.

*Naureda Llagami:* Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi caktimin e zonjës {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, në pozicionin e Këshilltarit për Etikën, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, pa u shkëputur nga ushtrimi i detyrës së gjyqtarit. Këshilltari për Etikën shërben për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë dhe përfiton një trajtim financiar 5% shtesë page mbi pagën bruto fillestare të tij. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 3 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2019

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 11.10.2019)*

**Pika 4 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Metodologjia për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve jogjyqtarë për në Gjykatën e Lartë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:10 dhe mbaroi në orën 13:00.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

*Shënim:* Nuk mori pjesë në mbledhje **Erjon Muharremaj**, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. **Rudin Baqli**, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. **Helena Papa**, Drejtoreshë e Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
3. **Pjerin Prendi**, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
4. **Vildan Kaloshi**, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.
5. **Krisulla Kasaj**, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.
6. **Valbona Bako**, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.
7. **Elis Kuçi**, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.
8. **Entela Dobi**, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.
9. **Tahir Lamçe**, OSCE.
10. **Armand Sokoli**, KSHH.
11. **Klodian Rado**, EURALIUS.
12. **Julinda Beqiraj**, EURALIUS.
13. **Arlind Maloku**, Qendra Evropiane.
14. **Erion Fejzulla**, USAID.
15. **Ervin Karamuço**, ISP.

#### **RENDI I DITËS:**

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Metodologjia për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve jogjyqtarë për në Gjykatën e Lartë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

**Naureda Llagami:** Kalojmë në projekt-aktin tjetër, sipas rendit të ditës. Edhe projekt-akti që relatohet është një projekt-akt shumë i rëndësishëm. Bëhet fjalë për “Metodologjinë për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve jogjyqtarë për në Gjykatën e Lartë”, projekt-akt i cili është përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Siç jeni në dijeni, gjatë gjithë këtyre mbledhjeve Këshilli ka ndërmarrë një sërë projekt-aktesh, ka

miratuar një sërë projekt-aktesh muajve të fundit, për funksionalizimin e Gjykatës së Lartë. Jemi të gjithë të ndërgjegjshëm dhe për rëndësinë që ka ky proces. Është një test serioziteti jo vetëm për Këshillin por edhe për të ardhmen e kësaj gjykate. Sot do të diskutojmë një projektvendim në funksion të vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve jogjyqtarë.

Unë dëshiroj në radhë të parë të falënderoj Komisionin për punën e palodhur të bërë gjatë gjithë kësaj periudhe dhe gjithashtu edhe Projektin EURALIUS i cili na ka asistuar në çdo vendimmarrjen tonë, për sa i përket hartimit të projekt-rregulloreve dhe në këtë rast do dëshiroja të falënderoja në mënyrë të veçantë {...}, e cila me thënë të vërtetën ka ndenjur pa u lodhur me ne në çdo hap të hartimit të këtij projekt-akti.

Për më shumë detaje, fjalën ia kaloj kryetarit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, zotit Ilir Toska.

***Ilir Toska:*** Faleminderit!

Atëherë, në vijim të fjalës tuaj Kryetare, ne kemi përgatitur një relacion në lidhje me “Metodologjinë për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve jogjyqtarë për në Gjykatën e Lartë”. Në fakt nuk është vetëm kontribut i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, por siç thatë edhe ju është edhe kontribut i Misionit EURALIUS, por edhe i gjithë anëtarëve të tjerë të Këshillit.

Atëherë, po ju lexoj relacionin që është përgatitur në lidhje me këtë projekt-akt.

Siç jeni në dijeni, Këshilli i Lartë Gjyqësor, në përmbushje të përgjegjësisë për mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor, në respektim të parimit qeverisës të eficiencës, në ushtrim të kompetencave në lidhje me administrimin e sistemit gjyqësor, bazuar në nenin 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenet 3, 4 dhe 49 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka filluar procesin për miratimin e rregullave më të detajuara, të cilat do të përcaktojnë kriteret dhe procedurën që do të zbatohen për përzgjedhjen e kandidatëve jogjyqtarë për emërimin në një pozicion të lirë në Gjykatën e Lartë. Vlerësimi, pikëzimi dhe renditja e kandidatëve për vendet vakante në Gjykatën e Lartë bëhet duke u bazuar në kriteret e parashikuar në nenin 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenet 3, 4 dhe 49 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Sa më sipër, pas vendimit nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës

së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar vendimin nr.102, datë 05.07.2019 “Për kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jogjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë”. Në këtë vendim përcaktohen rregulla më të hollësishme për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jogjyqtarë në Gjykatën e Lartë, ashtu si dhe në pikën 4 dhe 7, të kreut IV të tij, ngarkohet Këshilli i Lartë Gjyqësor që të miratojë edhe metodologjinë që përmban shpjegime mbi mënyrën se si Këshilli orientohet...

*(Ndërpritet mbledhja për pak minuta për shkak të shkëputjes së energjisë elektrike.)*

Mirë atëherë, referuar vendimit 102 të datës 05.07.2019, Këshilli ka marrë përsipër detyrimin që të miratojë metodologjinë ku do të bëhet një detajim i mëtejshëm i kritereve ligjore të vlerësimit që parashikohen në shtojcën e këtij vendimi, ku do të bëhet ndarja e kategorive të vlerësimit në kritere, listat dhe kriteret që përmbajnë secilën kategori, treguesit vlerësues për pikëzimin maksimal për secilën kategori dhe kriter si dhe, burime dokumentare dhe disa të dhëna për metodologjinë në funksion të vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve.

Metodologjia e propozuar nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve jogjyqtarë për në Gjykatën e Lartë shpjegon orientimet që mban parasysh Këshilli në vlerësimin dhe caktimin e pikëve sipas secilës prej kategorive të meritave të kandidatëve.

Për meritat profesionale, është kriteri i parë për të cilin do të vlerësohen kandidatët jogjyqtarë për në Gjykatën e Lartë, i cili ka në total 75 pikë. Treguesit që aplikohen për të vlerësuar këtë kriter janë të ndara në seksione si më poshtë:

A. Historiku arsimor dhe e shkuara profesionale (20 pikë), i cili përbëhet nga:

Historiku arsimor (2 pikë). Sipas këtij treguesi, caktimi i pikëve nga Këshilli për secilin kandidat orientohet duke u bazuar në rezultatet e studimeve të larta për drejtësi, brenda apo jashtë vendit. Në caktimin e pikëve për secilin kandidat Këshilli orientohet sipas vlerësimeve si më poshtë: Nota mesatare 8 – 9 (1 pikë); Nota mesatare mbi 9 (2 pikë).

Vlerësimi i kandidatit që ka kryer studimet jashtë vendit, bëhet mbi bazën e dokumentacionit të lëshuar nga një institucion i huaj i arsimit të lartë, i njësuar nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në rastin e kandidatëve që kanë përfunduar studimet për drejtësi të



ciklit të dytë, mesatarja përlogaritet sipas mesatares së rezultateve të të dy cikleve të studimit;

Rezultatet e programeve të formimit fillestar (2 pikë). Duke marrë parasysh të dhënat dhe informacionet në dispozicion, Këshilli cakton 1 pikë për rezultatet e studimeve të vlerësuara një nivel më të ulët se niveli maksimal (“mirë” ose “shumë mirë”, sipas programit) dhe 2 pikë për rezultate të vlerësuara në nivelin maksimal (“shumë mirë” ose “shkëlqyeshëm”, sipas programit);

Rezultatet e përvojës në profesion (4 pikë). Ky tregues vlerëson nivelin e rezultateve të arritura gjatë përvojës së kandidatit në profesionin e juristit. Duke marrë parasysh të dhënat dhe informacionet në dispozicion, Këshilli cakton 2 pikë për rezultatet e arritura gjatë përvojës profesionale si jurist të vlerësuara një nivel më të ulët se niveli maksimal (“mirë” ose “shumë mirë”, sipas llojit të profilit) dhe 4 pikë për rezultatet e vlerësuara në nivelin maksimal (“shumë mirë” ose “shkëlqyeshëm”, sipas llojit të profilit);

Rezultatet e trajnimeve të tjera, kualifikimeve pasuniversitare dhe gradat/titujt shkencorë (8 pikë). Për të pikëzuar këtë kriter, Këshilli vlerëson rezultatet e trajnimeve të tjera (deri në 2 pikë), kualifikimet pasuniversitare (deri në 3 pikë), si edhe gradat shkencore dhe titujt akademikë (deri në 4 pikë). Në çdo rast, totali i pikëve të caktuara nuk mund të jetë më i lartë se maksimumi i pikëve për këtë kriter;

Aftësitë gjuhësore (4 pikë). Në vlerësimin dhe pikëzimin e shkallës së zotërimit të gjuhëve të huaja sipas këtij kriteri, Këshilli mban parasysh njohjen nga kandidatët të pesë gjuhëve të huaja (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht dhe spanjisht). Në mënyrë të veçantë, vlerëson dhe pikëzon me përparësi njohuritë në gjuhën angleze dhe franceze. Shkalla e zotërimit të aftësive gjuhësore të kandidatit vlerësohet deri në 1.5 pikë për secilën gjuhë. Për vlerësimin e njohurive për gjuhët e huaja, në rastet kur e vlerëson të nevojshme, Këshilli cakton ekspertë të gjuhës së huaj, të cilët japin mendim për shkallën e zotërimit të aftësive gjuhësore të kandidatit.

Një tjetër tregues për vlerësimin e meritave profesionale të kandidatit është edhe Kualifikimi i përgjithshëm profesional, i cili në total ka 25 pikë. Pas vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve sipas historikut të arsimit dhe të shkuarës së tyre profesionale (Seksioni A “Historiku arsimor dhe e shkuara profesionale”), ky Seksion B synon të identifikojë ata kandidatë të cilët kanë performuar në mënyrë të dalluar në fushën përkatëse

të ushtrimit të profesionit. Prandaj, Seksioni B synon të vlerësojë dhe pikëzojë kandidatët duke u mbështetur në arritjet e rezultateve më të larta dhe të dallueshme profesionale, të konsideruara në përgjithësi.

Në vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve, Këshilli vlerëson cilësinë e aftësive profesionale duke u nisur nga: Vlerësimi cilësor. Midis të gjitha punimeve dhe dokumenteve profesionale gjatë pesë viteve të fundit të karrierës, kandidati për zgjedh dhe i parashtron Këshillit, pesë ndër punimet më të dallueshme sipas tij, ku paraqiten aftësitë e tij/saj intelektuale dhe profesionale në nivelin më të lartë. Elemente shtesë mbi cilësinë e rezultateve profesionale mund të nxirren nga dokumentet zyrtare për rezultatet e procesit të vlerësimit profesional të paraqitura nga kandidati ose të kërkuara nga ana e Këshillit prej autoriteteve përkatëse, si edhe dokumentet zyrtare që paraqesin cilësinë dhe arritjet gjatë eksperiencës në punë, nga institucione kombëtare dhe ndërkombëtare.

Pesë dokumentet profesionale vlerësohen nga Këshilli në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar, mbështetur në tregues të tillë si:

Origjinaliteti dhe/ose impakti (5 pikë). Këshilli, në këtë rast, vlerëson nivelin e njohurive të reja të nxjerra nga pesë dokumentet e paraqitura prej kandidatit – në vend të përmbledhjes së thjeshtë të njohurive tashmë të njohura – edhe pse kandidati mund të ketë nxjerrë argumente nga punë të tjera kërkimore për të mbështetur argumentet e tij;

Aftësitë analitike dhe hulumtuese (5 pikë). Aftësitë analitike i referohen mundësisë për të mbledhur dhe për të analizuar informacione dhe për të identifikuar zgjidhje me anë të një zhvillimi logjik të koncepteve ligjore. Aftësitë kërkimore i referohen aftësisë për të kërkuar, lokalizuar, organizuar dhe përdorur informacionet të cilat janë relevante për një temë të caktuar;

Saktësia, konciziteti, zhvillimi logjik, lexueshmëria, kuptueshmëria dhe gjithëpërfshirja (5 pikë). Nëpërmjet këtyre treguesve Këshilli vlerëson nëse 5 dokumentet e paraqitura, kandidati bën një përcaktim të qartë të problemit; identifikon problemin paraprakisht, zhvillon në mënyrë logjike konceptet juridike, përdor në mënyrë korrekte dhe konsistente termat teknike. Këshilli vlerëson gjithashtu nëse kandidati/ja përdor një gjuhë të thjeshtë dhe të drejtpërdrejtë, nëse rregullat gramatikore dhe të sintaksës përdoren në mënyrë të saktë, etj.;

Treguesi tjetër është - Interpretimi i harmonizuar (që edhe ky ka 5 pikë). Nëpërmjet këtij treguesi Këshilli vlerëson aftësinë e kandidatit për të identifikuar dhe interpretuar në mënyrë të harmonizuar burimet e ndryshme të së drejtës si edhe për të treguar dhe argumentuar ligjin e zbatueshëm për zgjidhjen e problemit;

Së fundi, treguesi tjetër është - Referencat e praktikës gjyqësore (që edhe kjo është 5 pikë). Për të pikëzuar kualifikimin e përgjithshëm profesional të kandidatëve Këshilli vlerëson edhe aftësitë e kandidatëve për të referuar dhe trajtuar me efektivitet, në vendin e duhur dhe sipas llojit dhe qëllimit të aktit, praktikën e konsoliduar gjyqësore, praktikën e unifikuar të Gjykatës së Lartë, praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe jurisprudencën në përgjithësi.

Në rastin e plagjiaturës, nëse verifikohet nga bordi vlerësues i revistës apo institucion tjetër gjatë procedurës së vlerësimit, rezultatet e përgjithshme të këtij Seksioni, “Kualifikimi i përgjithshëm profesional” vlerësohen 0 pikë.

Kualifikimet shtesë profesionale, është treguesi i tretë i kriterit të Meritave Profesionale, i cili ka në total 20 pikë (*në material është e shënuar 30 pikë*). Ky kriter i pikëzimit të meritave profesionale synon të vlerësojë rëndësinë dhe dobinë e specializimit të arritur në përvojën e veçantë profesionale të kandidatit, në mënyrë që të sigurojë plotësimin e ekspertizës profesionale dhe të pasurojë kapacitetet profesionale të Gjykatës së Lartë. Si e tillë, perspektiva e vlerësimit është e ndryshme nga vlerësimi i “kualifikimit të përgjithshëm profesional” në Seksionin B më lart. Në varësi të profilit të tyre kandidatët vlerësohen duke marrë një maksimum prej 30 pikësh. Në varësi të së shkuarës profesionale dhe specializimit të kandidatëve Këshilli diferencon pikëzimin ndërmjet tyre, në bazë të:

i. Kohëzgjatja e angazhimit në fushën specifike (6 pikë). Sipas të cilit për angazhimin nga 1-3 vite kandidimi vlerësohet me 1 pikë, për angazhime mbi 3-6 vite vlerësohet me 2 pikë, për angazhime mbi 6-9 vite vlerësohet me 3 pikë; për angazhime mbi 9-12 vite vlerësohet me 4 pikë; për angazhime mbi 12-15 vite vlerësohet me 5 pikë; si dhe për angazhime mbi 15 vite vlerësohet me 6 pikë;

ii. Botime relevante dhe ndikimi i rezultateve profesionale në fushën specifike (6 pikë). Këshilli cakton deri në 2 pikë për botime relevante në fushën specifike, të tilla si monografi, artikuj në revista shkencore, raporte, udhëzues, komentare etj. Këshilli cakton deri në 2 pikë shtesë nëse botimet relevante dhe ndikimi i rezultateve profesionale të

kandidatit në fushën specifike janë realizuar në vendet e BE/OECD. Gjithashtu, Këshilli cakton deri në 2 pikë shtesë për impaktin e botimeve relevante të kandidatit në zhvillimin e doktrinës dhe të jurisprudencës gjyqësore në këtë fushë;

iii. Konsulenca dhe kontributet në hartimin e legjislacionit (6 pikë). Për të vlerësuar këtë tregues Këshilli cakton deri në 4 pikë për konsulencat në fushën përkatëse të së drejtës si edhe për kontributet në hartimin e legjislacionit, bazuar në të dhëna të dokumentuara. Këshilli vlerëson rolin, sasinë dhe cilësinë e angazhimit, dhe ndikimin në veprimtarinë specifike. Këshilli cakton deri në 2 pikë shtesë për shtrirjen ndërkombëtare të angazhimit duke vlerësuar nëse konsulenca në fushën përkatëse të ligjit është realizuar në vendet e BE/OECD;

iv. Pjesëmarrja në konferenca shkencore, mësimdhënie, çmime dhe tituj (gjithsej 12 pikë). Për të pikëzuar kandidatët, Këshilli vlerëson në veçanti edhe referimet në konferenca shkencore kombëtare, në fushën specifike të specializimit, bazuar në fjalimet e dorëzuara, dhe cakton deri në 2 pikë, duke marrë parasysh numrin e referimeve dhe rolin e referuesit. Këshilli cakton deri në 2 pikë shtesë nëse referimet në fushën specifike – të dokumentuara nga fjalimet e dorëzuara nga kandidati janë realizuar në konferenca shkencore ndërkombëtare në vendet e BE/OECD, duke marrë parasysh numrin e referimeve dhe rolin e referuesit. Këshilli vlerëson edhe përvojën e mësimdhënies, në fushën specifike të specializimit, për profesionistët (për shembull gjyqtarët, prokurorët, avokatët etj.), dhe duke marrë parasysh numrin e angazhimeve, kohëzgjatjen, institucionin, rolin si mësimdhënës/trajnuar, cakton deri në 4 pikë. Për përvojën si pedagog, me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme ose si “profesor vizitor/personel akademik i ftuar”, në fushën specifike të specializimit, në vendet e BE/OECD, Këshilli cakton deri në 2 pikë. Kandidatit i caktohen gjithashtu deri në 2 pikë për çmime ose tituj të veçantë nderi në vendet e BE/OECD.

Grupi i dytë i kriterëve “Meritat morale dhe etike” janë kategoria e dytë e kriterëve që shërbejnë për identifikimin e kandidatit që përfaqëson juristin më të spikatur, të cilat kanë në total 15 pikë. Për të pikëzuar këtë kriter Këshilli vlerëson nëse kandidati miraton, respekton dhe mbështet vlerat themelore të punës së gjyqtarit, siç janë:

Shmangia e shfaqjes së pahijshme (5 pikë). Shmangia e shfaqjes së pahijshme është themelore për integritetin. Këshilli vlerëson nëse kandidati, në ushtrimin e detyrës dhe funksioneve, i shmanget çdo sjelljeje që tregon mungesë respekti, vetëpërmbytjeje,

ndjeshmërie, apo qasje të papërshtatshme dhe ofensive - pra jo vetëm sjellje që formalisht kualifikohen se janë në kundërshtim me ligjin;

Nderi dhe dinjiteti (dhe ky tregues ka 5 pikë). Në lidhje me nderin dhe dinjitetin, Këshilli vlerëson nëse kandidati transmeton vlera personale dhe profesionale dhe konsiderohet një model për të tjerët;

Treguesi tjetër - Reputacioni (i cili edhe ai ka 5 pikë). Në përgjithësi, qëllimi i këtij treguesi është të vlerësojë nëse dhe deri në çfarë mase kandidati mund të pranohet se përmbush pritshmëritë e qytetarëve dhe të shoqërisë në lidhje me cilësitë profesionale të gjyqtarit, të tilla si: rezerva dhe diskrecioni, kujdesi dhe respekti, si dhe cilësitë personale si: mençuria, besnikëria, humanizmi, serioziteti dhe maturia.

Këshilli për vlerësimin e kriterit të “Meritat morale dhe etike” përqendrohet në jetëshkrimin e kandidatit; në dokumente zyrtare që tregojnë arritje mbi nivelin e etikës dhe cilësive morale gjatë përvojave të punës; në informacione zyrtare të ardhura posaçërisht ose të bëra vetë publike nga institucione të tjera shtetërore; në informacione dhe opinione të ardhura nga institucionet publike që kanë lidhje me sistemin e drejtësisë, organizata të shoqërisë civile me veprimtari në mbrojtjen e të drejtave të njeriut ose të krijuara për mbrojtjen e interesave të përdoruesve të sistemit të drejtësisë; në informacione dhe dokumente të tjera të aksesueshme publikisht ose të paraqitura në Këshill, si edhe në intervistën me kandidatin. Të dhënat e dala nga burimet e vlerësimit analizohen në mënyrë objektive duke shmangur qëndrimin subjektiv të vlerësuesit apo anëtarit të Këshillit të krijuar mbi bazën e njohjeve personale me kandidatët.

Grupi i tretë i kriterëve - “Meritat organizative dhe menaxheriale”, janë kriteri i tretë për identifikimin e juristit më të spikatur janë “, të cilat kanë në total kanë 10 pikë. Për të pikëzuar këtë kriter, Këshilli do të mbështetet në treguesit si më poshtë:

Cilësia e platformës dhe e vizionit të paraqitur (2 pikë). Në lidhje me këtë tregues Këshilli do të vlerësojë sa vijon:

a) nivelin e kuptimit që kandidati ka për rolin e tij si gjyqtar në Gjykatën e Lartë dhe për rolin e Gjykatës së Lartë si e tillë;

b) vizionin e kandidatit në lidhje me sfidat kryesore me të cilat përballlet Gjykata e Lartë nga perspektiva organizative dhe e çështjeve thelbësore të së drejtës;

c) mendimet dhe sugjerimet e kandidatit për t’i adresuar këto sfida.

ii. Aftësitë vendimmarrëse (që referohet të ketë 4 pikë). Këshilli do të vlerësojë këtu nivelin e aftësive të fituara në përvojën, pozicionet dhe përgjegjësitë e mbuluara, në lidhje me aspektet që kanë të bëjnë me menaxhimin, planifikimin dhe administrimin e punës. Këshilli mund të vendosë të caktojë pikë shtesë për kandidatët që kanë mbajtur pozicione drejtuese ose që kanë kryer funksione që përfshijnë vendimmarrje me efekt të drejtpërdrejtë ndaj palëve të treta;

Aftësitë e komunikimit (2 pikë). Për të pikëzuar këtë kriter, Këshilli do të vlerësojë aftësinë për t'u shprehur në mënyrë të kuptueshme të qartë dhe koncize. Këshilli do të vlerësojë gjithashtu nëse kandidati është në gjendje të komunikojë me subjektet e tjera dhe të tretët në mënyrë jodiskriminuese, të matur, dhe me respekt;

iv. Puna në ekip dhe puna në ambiente multidisiplinore (që është përcaktuar 2 pikë). Sipas kësaj, kandidati i përshtatshëm për gjyqtar në Gjykatën e Lartë duhet të ketë kompetenca dhe aftësi për të punuar në kolegje me gjyqtarë të tjerë, për të shkëmbyer lirshëm dhe në mënyrë efektive pikëpamjet me kolegët dhe disponueshmërinë për të negociuar mospërputhjen e pikëpamjeve, nëse këto shfaqen. Kandidati duhet të demonstrojë një qasje metodike ndaj punës, si dhe aftësinë për të qenë pjesë e një komuniteti pune, domethënë aftësinë për të punuar në ekipe me kolegët dhe anëtarët e stafit. Për të pikëzuar këtë tregues, Këshilli do të vlerësojë eksperiencën e kandidatit gjatë karrierës, në punë në ekip, në ambiente ndërkombëtare dhe multidisiplinore. Faleminderit! Ky ishte relacioni i përgatitur për këtë pikë të rendit të ditës.

**Naureda Llagami:** Shumë faleminderit zoti Ilir Toska lidhur me pjesën e relatimit të këtij projekt-akti.

Atëherë, unë i ftoj të gjithë kolegët nëse kemi diskutime apo sugjerime konkrete, përtej atyre diskutimeve që kemi bërë në grupet tona të punës.

**Medi Bici:** Meqenëse s'po e merr fjalën njeri, kisha unë nja dy gjëra që mbetem i paqartë. Nuk kam problem me pjesën profesionale, por tek pjesa morale e kisha më tepër. Më duket se ngelen pa pasqyruar nga tre momente, -me sa kam parë unë ose jam i gabuar. Pra nëse ndonjë nga juristët e spikatur që do na vijë për kandidim, rezulton që të ketë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut gjatë detyrave që ka kryer më parë, -si do veprohet?

Ne kemi thënë që – të paktën në bisedimet që kemi bërë, nuk e di nëse është pasqyruar – që juristët e spikatur që kanë dhënë kontribut për reformat ligjore në Shqipëri do

marrin një bonus dhe unë jam shumë dakord, për reforma që kanë dhënë efekte, një ligj që ka dhënë efekte të mira. Po nëse do të ketë nga juristët e spikatur që kanë kandiduar dhe kanë marrë pjesë në reformat e vitit '91-'92, '94, '98, '99, '95-2007, të gjitha të dështuara, - si do veprohet? Ne prandaj jemi mbledhur, që t'i riparojmë këto gjëra.

Dhe e treta, nëse do të paraqiten juristë të spikatur që kanë patur askes në emërimet në gjykatë dhe në prokurori, të cilat ekzistojnë të dështuara, - a kanë të drejtë, a kanë moral ato që të paraqesin kandidaturat e tyre? Këto tre më ngelen pa sqaruar.

**Brikena Ukperaj:** Kam një pyetje. Mund të ketë juristë të spikatur që kanë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të njeriut?

**Medi Bici:** Patjetër!

**Brikena Ukperaj:** Si mund të vijë ky informacion?

**Medi Bici:** Tani, moshë e Gjykatës së Lartë ka shkuar në 70 vjeç, ka të drejtë që të paraqesë një kërkesë edhe një jurist që është në moshën 69 vjeç, që i bie që të ketë punuar 20 vjet para vitit '90. Në Republikën e Shqipërisë, kanë vdekur jo një por disa vetë në hetuesi. Nëse do të na paraqitet një kandidat i tillë, si do të...?

**Naureda Llagami:** Atëherë, zoti Toska, të lutem!

**Ilir Toska:** Atëherë, kjo është çështje e figurës. Nuk besoj se është çështje e pikëzimit, por është çështje e figurës. Dhe nëse ne vlerësojmë që figura e një kandidati nuk është e atillë ne do ta skualifikojmë që fazën e parë dhe nuk do shkojë problemi që sa pikë duhet t'i japim. Dikush që nuk meriton të hyjë në Gjykatën e Lartë, do duhet të skualifikohet që në fazën e parë, që në fazën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit.

Sa i përket reformave të dështuara, kjo është rast pas rasti. Nuk di si mund t'i them emrin një që do aplikojë, që nuk e di kush është, nuk di kush është reforma e dështuar, nuk di se kush do të jetë ajo çfarë ka bërë kandidati, thjesht do duhet të hamendësojmë, pra është një çështje që duhet ta trajtojmë rast pas rasti. Nëse dikush në aktivitetin e tij profesional ka mangësi, nuk tregon që ka dhënë përvojën më të mirë, nuk ka bërë mirë detyrat, kuptohet që s' duhet të vlerësohet pozitivisht ose do të vlerësohet minimalisht. Faleminderit!

**Medi Bici:** Personat që kanë pas akses në emërimet në prokurori dhe në gjykata?

**Ilir Toska:** E njëjta gjë është ajo. Çdokush, gjatë karrierës së vet ka treguar një...

**Medi Bici:** Sepse nisem nga – më fal – nisem nga fakti që pjesa më e madhe e gjyqtarëve, 50% e gjyqtarëve dhe prokurorëve po shkarkohen. Këto emërimet nuk i kam bërë unë, as Dritani.

**Ilir Toska:** Çdokush ka përvojën e vet dhe ka reflektuar në punën e vet ato që ka reflektuar. Ne sot do duhet t'i konsiderojmë për efekt të vlerësimit profesional të tyre, qoftë edhe sa i përket figurës, dinjitetit të tyre. Në çdo rast do duhet të konsiderojmë çdo informacion të vlefshëm që a është i vërtetuar dhe i besueshëm dhe i mjaftueshëm, për çdo çështje që ne do duhet të konsiderojmë për efekt, qoftë të verifikimit dhe kriterëve dhe kushteve ligjore të kandidimit ashtu edhe sa i përket vlerësimit, pikëzimit të tyre.

**Brikena Ukperaj:** Shqetësimi që paraqet zoti Medi është edhe pjesë e vlerësimit personal të secilit kandidat, se si ai i vlerëson aspekte të rëndësishme të meritave morale dhe profesionale në pikëzim. Dikush, një kontributi të tillë mund t'i japë pikëzimin maksimal, dikush mund t'i japë mesataren, dikush mund t'i japë dhe një pikë dhe dy pikë. Pra është çështje se si secili subjektivisht e vlerëson dhe arsyeton atë pikëzim që jep. Konsulenca, kontributi, përvoja profesionale, të gjitha janë parashikuar.

**Brunilda Kadi:** ...se është vetë zoti Bici, e ta thotë. A është parashikuar në këtë metodologji që ne mund të vlerësojmë një person, një kandidat i cili ka marrë pjesë në emërimet të gjyqtarëve apo të prokurorëve, të cilat sot nga reforma kanë rezultuar të dështuara. Ky në fakt është një fakt që s'është shumë subjektiv, se nëse ka marrë pjesë në emërimet apo jo është një fakt objektiv dhe nëse i janë shkarkuar emërimet e tij apo të saj edhe ky është një fakt objektiv domethënë, e shikojmë. Kam përshtypjen që pyetja ishte, - një situatë e tillë në metodologji është parashikuar që mund të penalizojë apo favorizojë kandidatin?

**Ilir Toska:** Të lutem, unë nuk besoj që në një metodologji duhet të shkruajmë edhe specifika të kësaj natyre. Këto janë konkrete dhe do duhet t'i trajtojmë rast pas rasti. Por metodologjia konsideron që duhet t'i trajtojmë se s'bën, çdo gjë që kemi për kandidatët. Kjo nuk përjashtohet. Çdo e dhënë që ka të bëjë me përvojën profesionale do duhet ta konsiderojmë për efekt vlerësimi. Nuk mundet dot në metodologji të marrim me emërtesa kush ka bërë këtë punë, do kemi këtë vlerësim. Do ishte pak e tepruar kjo gjë, përveçse nuk do arrinim dot ta bënim këtë gjë, se kjo gjë do bëhet rast pas rasti. Por që duhet të bëhet.

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toska!



**Marçela Shehu:** Në metodologji, situatat që janë parashikuar nuk janë shteruese, që do të thotë që rast pas rasti, çdo kandidat me rrethana të tjera specifike do të vlerësohet dhe do të trajtohet nga Këshilli. Pra në metodologji, ashtu siç e tha edhe Iliri, nuk mund të marrim përsipër që të parashikojmë të gjithë situatat konkrete në të cilat mund të ndodhen kandidatët që paraqiten.

**Brikena Ukperaj:** Unë e kisha në një këndvështrim tjetër, që në qoftë se ne në metodologji kemi përcaktuar se cilat janë burimet e vlerësimit, në aspekte të ndryshme të vlerësimit, nga të tre kriteret, qoftë profesionali, qoftë meritat dhe qoftë organizative, këto burime mund të përdoren në mënyra të ndryshme dhe të interpretohen nga secili kandidat për efekt të pikëzimit që do t'i japë në atë kriter. Nuk mund të themi sot që këtë indikator ne do ta marrim parasysh kur të vlerësojmë rezultatet e ekspertizës ose të konsulencës ose të punës së kandidatit dhe nuk do ta vlerësojmë tek elementë të veçantë të figurës.

**Naureda Llagami:** Ndonjë koment tjetër ose paqartësi?

Jo!

Atëherë, kalojmë në votim të projekt-aktit?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro, me rezervën e mësipërme që citova.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, lidhur me rezervën duhet të kemi propozim konkret zoti Bici, për sa i përket nëse jeni... konkretisht. Sepse kjo rezerva është shumë abstrakte. Në qoftë se doni një propozim konkret ku duhet të ndryshohet, duhet të vini me propozimin konkret. Vota me rezervë nuk është diçka që lë...

**Medi Bici:** Nuk kam propozim.

**Naureda Llagami:** Okej! Faleminderit! Pro!

Atëherë, Këshilli vendosi: Miratimin e Metodologjisë për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve jogjyqtarë për në Gjykatën e Lartë, sipas tekstit bashkëlidhur, të propozuar nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës dhe Etikës. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare. Faleminderit!

\* \* \*

(Pika 4 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.\_\_.2019

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 11.10.2019)*

**Pika 5 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i kërkesës së gjyqtarës {...}, për përjashtim nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme” i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:10 dhe mbaroi në orën 13:00.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Maksim Qoku* (zëvendëskryetar)
3. *Medi Bici* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Brunilda Kadi* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Illir Toska* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Marçela Shehu* (anëtare)

*Shënim:* Nuk mori pjesë në mbledhje *Erjon Muharremaj*, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtoreshë e Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
5. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
6. *Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
7. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
8. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
9. *Tahir Lamçe, OSCE.*
10. *Armand Sokoli, KSHH.*
11. *Klodian Rado, EURALIUS.*
12. *Julinda Beqiraj, EURALIUS.*
13. *Arlind Maloku, Qendra Evropiane.*
14. *Erion Fejzulla, USAID.*
15. *Ervin Karamuço, ISP.*

#### **RENDI I DITËS:**

5. Shqyrtimi i kërkesës së gjyqtarës {...}, për përjashtim nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme” i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

*Naureda Llagami:* Kalojmë tek çështja tjetër që ka të bëjë me... Si fillim do bëjmë shqyrtimin e kërkesës së gjyqtarës {...}, për përjashtimin nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku

ushtron funksionin në mënyrë të përhershme. Dhe më pas do fillojmë me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, në ndryshim nga ato ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme. Të dy projekt-aktet do i relatojë... Okej, i pari do relatohet nga zoti Toro.

***Alban Toro:*** Faleminderit!

Atëherë, pranë Këshilli të Lartë Gjyqësor, me aktin 4900, 07.10.2019, është regjistruar kërkesa e datës 03.10.2019, me lëndë: “Kërkesë për përjashtimin nga skema e delegimit”, e znj. {...}, aktualisht gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë. Nëpërmjet kësaj kërkesë, gjyqtarja kërkon të përjashtohet nga caktimi në gjykata të tjera për të gjykuar çështje të veçanta, për arsye familjare, pasi është nënë e një fëmije të mitur vetëm 14 muajshe. Gjyqtarja shprehet në kërkesën e saj se distanca e largët që ajo duhet të përshkojë për në gjykatat e tjera jashtë rrethit të Sarandës, e vë në vështirësi familjare lidhur me perkujdesjen dhe mirëritjen e fëmijës së mitur.

Për sa më sipër, gjyqtarja kërkon të përjashtohet nga procedura e caktimit në gjykata të tjera për të gjykuar çështje të veçanta për një afat njëvjeçar. Bashkëngjitur kërkesës është përfshirë edhe certifikata familjare e kërkueses.

Aktualisht, në vendimin nr. 30, datë 14.02.2019 të KLGJ-së janë përcaktuar disa rregulla të cilat bëjnë fjalë për caktimin e gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme dhe gjithashtu në vendimin e KLGJ-së nr. 30, 14.02.2019 janë miratuar rregulla të detajuara. Në pjesën VIII, pika 6 e këtij vendimi parashikohen rastet e përjashtimit të gjyqtarit nga ky proces, dhe konkretisht është paragrafi ku shprehimisht përcaktohet se: “Me kërkesë të motivuar të gjyqtarit dhe të shoqëruar me aktet e nevojshme provuese, Këshilli i Lartë Gjyqësor, për arsye shëndetësore, mund të vendosë përjashtimin deri në gjashtë muaj të një gjyqtari nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta”.

Pra siç rezulton edhe nga interpretimi i këtij parashikimi, rezulton se, Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në kërkesën e motivuar të gjyqtarit dhe të shoqëruar me aktet e nevojshme provuese mund të vendosë përjashtimin nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta, kur ka të provuara shkaqe shëndetësore. Në rastin konkret, nga ana e gjyqtarës {...}, motivohet për shkaqe të cilat nuk kanë lidhje me shkaqet

shëndetësore por me arsye të lidhura me situatën e saj familjare dhe faktin që ka një fëmijë të vogël 14 muajshe, fakt që e pengon të ushtrojë kujdesin e duhur në kuadër të mirërritjes së tij.

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vlerëson, se ky shkak i referuar nga gjyqtarja, referuar vendimit nr. 30, 14.02.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, nuk përbën shkak për përjashtimin e saj nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme.

Në këtë kontekst, propozimi i Komisionit është: Duke u bazuar sa më sipër, konform edhe vendimit nr. 30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit mospranimin e kërkesës së gjyqtares {...} për përjashtimin gjer në një vit nga lista e gjyqtarëve që caktohen në gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta, në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme.

Bashkëlidhur këtij relacioni është përgatitur edhe projektvendimi përkatës, në dispozitivin e të cilit është parashikuar mospranimi i kërkesës së gjyqtares {...} për përjashtimin e saj nga lista e gjyqtarëve që caktohen në gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme. Ky vendim t'i komunikohet gjyqtares {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

***Naureda Llagami:*** Faleminderit, zoti Toro!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim lidhur me projekt-propozimin e sjellë nga Komisioni?

Po!

***Maksim Qoku:*** Faleminderit, zonja Kryetare!

Në fakt, është një kërkesë për herë të parë e kësaj natyre dhe do desha që ta marrim pak në konsideratë situatën. Është e vërtetë që në referim fjalë për fjalë të rregullores sonë, ashtu është, ne kemi parashikuar shkakun shëndetësor, por kjo nuk do të thotë që s'duhet të kemi parasysh ligjin. Në fund të fundit Kodi i Familjes është një ligj i posaçëm dhe interesi më i lartë i fëmijës prevalon mbi gjithçka. Për shembull, unë ndjej mungesë se nuk kam njëherë letrën e gjyqtares. Do desha ta lexoja, se duhet të jetë letër më e zgjeruar dhe krijon

një ide mbi atë çka ajo pretendon. Por ama, fare mirë di të them që situata në fjalë, mjafton interesi më i lartë i fëmijës, që prevalon mbi rregulloren, për atë shkak që ne kemi vendosur. Do desha të sugjeroja ta shikojmë pak më gjerë, se mbase në refuzimin që mund t'i bëjmë kërkesës, cenojmë edhe ligjin. Për më tepër, për të bërë edhe një praktikë sepse janë nëna përpara se janë magjistratë dhe, fëmija në atë moshë edhe e ka të nevojshme. Mundet që vërtet, për efekt të delegimit, të mund të shkaktojmë probleme të aspektit të mirërritjes dhe edukimit të fëmijës, duke qenë që lidhja e nënës me fëmijën, nuk është si lidhja e babait me fëmijën dhe, nisur edhe nga fakti që shpeshherë është edhe e pazëvendësueshme, mundet që të vëmë një kufi të moshës së fëmijës kur deri në ç'moshë e ka të nevojshme nënën, por edhe të kemi gjithmonë rast pas rasti parasysh situata të kësaj natyre. Kështu që, e lë për diskutim pastaj.

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Qoku!

Fjalën e ka zonja Kadi!

**Brunilda Kadi:** Edhe unë jam dakord me atë që tha zoti Qoku dhe nëse do jetë e nevojshme, ndoshta mund të... kolegëve të Komisionit të Karrierës, një propozim ndoshta për të ndryshuar edhe rregulloren sepse arsyet pse mund të kërkohet përjashtimi... për pikën e shkakut ku kërkohet përjashtimi nga procedurat e shortit, të vejmë edhe arsye të tjera të cilat... ta lejmë "të tjera" dhe ne ta shqyrtojmë rast pas rasti. Rasti konkret unë mendoj që është një rast që duhet shqyrtuar sepse për të gjithë ato arsye që tha parafolësi, se s'dua t'i përsëris. Kështu që, do e sugjeroja një ndryshim. Për sot, edhe unë do isha pro një interpretimi më të zgjeruar ndoshta të dispozitës dhe nëse janë të justifikuar pretendimet e gjyqtarës, të përjashtojmë, duke pasur parasysh edhe faktin që edhe rrethi gjyqësor ku ajo ushtron detyrën e saj është një rreth i largët dhe kam përshtypjen që edhe ajo edhe të qenit aty e ka me vështirësi, ka zhvendosur familjen e të gjitha.

Dakord pra, por do jetë zhvendosur. Kam përshtypjen që banesën e saj të përhershme nuk e ka patur në Sarandë kur është emëruar. Faleminderit!

**Marçela Shehu:** Unë jam dakord që të rimendohet dhe të rivlerësohet ndonjë ndryshim i mundshëm në rregullore, nëse do të jetë edhe Këshilli dakord. Ndërsa lidhur me rastin konkret, pra me kërkesën e paraqitur nga zonja {...} dhe shkakun që ajo ka paraqitur, përveç faktit që në rregullore ky fakt dhe kjo rrethanë nuk parashikohet, ju sjell në vëmendje gjithashtu që shumica e gjyqtarëve femra dhe meshkuj kanë fëmijë të mitur dhe nëse do t'i

përrjashtonim dhe do t'i vlerësonim çdo rast si shkak për t'u përrjashtuar nga delegimi, mendoj që lista e gjyqtarëve që do të mbeteshin për t'u deleguar do të ishte shumë e vogël ose nuk do kishim fare. Dhe besoj që edhe vet gjyqtaret femra – kur thotë Brikena, është diskriminuese – nuk do t'i pëlqente një diferencim dhe një diskriminim i tillë. Për sa kohë zonja shkon në punë, ajo është gjyqtare, ajo nuk shkon në shtëpi, ajo shkon çdo ditë në Gjykatën e Sarandës, gjykon. Ne nuk po i themi që ajo të shkojë në Gjykatën e Përmetit jashtë orarit zyrtar. Pra brenda orarit të punës mund të marrë të gjitha masat e nevojshme për ta organizuar punën në mënyrë të atillë që të jetë efektive në familje dhe në punë.

**Brikena Ukperaj:** Edhe diçka tjetër.

Gjyqtarja, aktualisht, nuk ka kërkuar që të reduktojë orarin e punës. Ajo punon 8 ore (8:00 me 16:00) dhe çështjet që ajo do shkojë të gjykojë janë gjatë kësaj periudhe. Delegimi nuk e impjon gjyqtaren me punë tjetër tej orarit zyrtar. Në momentin që ajo duhet ta kryejë punën brenda këtij orari, afërsia e Gjykatës së Përmetit apo Gjykatës së Gjirokastrës me Gjykatën e Sarandës është e tillë që e mundëson jo vetëm gjykimin brenda ditës por edhe transportin brenda orarit zyrtar të gjyqtares.

**Brunilda Kadi:** Me fal, se Përmeti me sa di unë është larg dhe zonja Ukperaj duhet ta ketë nga përvoja personale – edhe unë nga personale e kam, kur ka qenë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, që dilja në orën 06:00 të mëngjesit dhe kthehesha në 08:00 të darkës. Kështu që nuk është orar 08:00 me 16:00 si të jesh...

**Brikena Ukperaj:** Sepse ke zgjedhur që të mos jetoje në qytetin ku ushtron detyrën.

**Brunilda Kadi:** Po pra. Edhe ajo tani e ka zgjedhur, detyruar të ikë në Sarandë dhe tani do t'i duhet të largohet po nga Saranda dhe të shkojë në Përmet dhe kam përshtypjen që ajo nuk e realizon dot 08:00 me 16:00 dhe udhëtimin...

*(Zoti Toska flet pa ndezur mikrofonin.)*

Tani, s'e dimë, se varet si është çështja. Mund t'i duhet.

*(Zonja Shehu flet pa ndezur mikrofonin.)*

Po duhet të zhvendoset. Nuk e bën dot detyrën brenda orës 08:00 me 16:00 sepse 08:00 me 16:00 duhet të jetë në zyrë. Udhëtimin kur duhet ta bëjë kjo që të shkojë e të kthehet? Nuk do harxhoj 10 minuta të shkojë në punë, do harxhojë 1 orë e gjysmë, -ku e di unë, nuk e di sa është nga Saranda në...?

*(Disa nga anëtarët flasin pa ndezur mikrofonin.)*



**Marçela Shehu:** Të gjithë gjyqtarët që delegohen udhëtojnë, udhëtojnë më shumë se një orë, një orë e gjysmë për të gjykuar. Është çështje menaxhimi. Unë mendoj që është çështje menaxhimi. Mund ta organizojë punën në mënyrë të atillë që atë ditë të mos gjykojë në gjykatën ku ajo është e caktuar në mënyrë të përhershme, por të gjykojë në gjykatën tjetër. Dhe mendoj që nuk është e caktuar në shumë çështje zonja {...}. Në momentin që do të ketë një ngarkesë të caktuar (jo më shumë se 10 çështje), do të përjashtohet sipas rregullores nga delegimet.

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

Mua në fakt më pëlqen ndjeshmëria që kemi ndaj këtyre situatave, por që në rastin konkret mendoj që neve duhet të shohim edhe gjënë globale, sikurse tha edhe Marçela, që të gjithë gjyqtarët janë me fëmijë të vegjël, të gjithë mund të kemi të njëjtat kërkesa dhe Këshilli nuk mundet të bëjë përjashtime për një distancë të shkurtër që është nga Saranda në Përmet. Se kemi edhe gjyqtare që i çojmë nga Tirana deri në Korçë dhe tek ato mund të fillojë kjo lloj praktike.

Për atë që unë i thërras vëmendjen Komisionit, të jemi sensitivë për situata të posaçme që mund të kemi në raste konkrete për nëna me fëmijë, të cilat janë në kushte të cilat nuk mund të jenë në kushte të barabarta me të tjerat. Por jo ta bëjmë rrugë sepse 14 muajsh, mund të kemi shumë gjyqtare me fëmijë 14 muajsh. Është bashkëshorti aty, mund t'i mbulojë bashkëshorti pjesën tjetër që kanë, kujdesin ndaj fëmijës. Kështu që unë mendoj që nuk është çështje për diskutim. Është çështje për votim. Nëse nuk kemi më diskutime të tjera tashmë, kalojmë në votim?

**Maksim Qoku:** Kundër.

**Alban Toro:** Edhe diçka.

Atëherë, lidhur me ngarkesën emocionale në shkresë, nuk është se do gjeni ndonjë gjë të veçantë në atë kërkesë. Stafi jua vuri në dispozicion. Nga pikëpamja formale, rregullorja nuk ka gjë të parashikuar. Nga pikëpamja ligjore ligji për Statusin ka parashikuar mekanizma për subjekte, pra për magistratë të cilët kërkojnë për shkaqe familjare të ndryshme, të ulin ngarkesën në punë, leje të posaçme, etj., etj. Pra në këtë aspekt është i zgjidhur problemi. Nuk shikoj ndonjë kontraditë në lidhje me rregulloren. Kështu që, besoj që projektvendimi që kemi paraqitur është i drejtë dhe duhet miratuar.

**Maksim Qoku:** Pa e zgatur. Pa ju bezdisur fare.

Thashë, është një rast i herës së parë. Për efekt diskriminimi, e mbyllim. Sepse unë referova dhe thashë që vëmë një moshë, pra le të themi 18 muaj është një moshë 1 vjeç e gjysmë që fëmija është mirë dhe ky është 12 muajsh, pra mund ta vëmë. E dyta, që desha të them dhe e thashë, që nuk është rregullorja referencë sepse rregullorja është akt nënligjor po dhe ligji ynë, vetëm ai i vetmi i Statusit, janë dhe ligje të tjera. Prandaj e përmenda interesin e fëmijës. Pra ta kemi të qartë këtë gjë. Pastaj se si e mbajmë qëndrimin është tjetër gjë.

**Maksim Qoku:** Kundër.

**Brunilda Kadi:** Atëherë, pro duke shpjeguar, për të qenë koherent edhe me atë që thashë. Unë propozova nëse ka vend për të ndryshuar rregulloren. Por nisur për rastin konkret, duke qenë se nuk ka të dhëna konkrete dhe nuk më duket shumë e justifikuar sepse unë e diskutova në parim situatën, në këtë rast, me këto të dhëna që jepen edhe unë jam pro propozimit të Komisionit.

**Dritan Hallunaj:** Kundër.

**Ilir Toska:** Pro.

**Alban Toro:** Pro.

**Fatmira Luli:** Pro.

*(Vota e zonjës Shehu nuk dëgjohet.)*

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Kundër. Duhet të merret parasysh interesi më i lartë i fëmijës.

**Naureda Llagami:** Pro.

Atëherë, Këshilli vendosi, me shumicë votash, mospranimin e kërkesës së gjyqtarës {...} për përjashtimin e saj nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme. Ky vendim do t'i komunikohet gjyqtarës {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë. Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 5 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2019

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 11.10.2019)*

**Pika 6 e rendit të ditës me objekt:** Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:10 dhe mbaroi në orën 13:00.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

*Shënim:* Nuk mori pjesë në mbledhje **Erjon Muharremaj**, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. **Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
2. **Helena Papa, Drejtoreshë e Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
3. **Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
4. **Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
5. **Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.**
6. **Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.**
7. **Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**
8. **Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
9. **Tahir Lamçe, OSCE.**
10. **Armand Sokoli, KSHH.**
11. **Klodian Rado, EURALIUS.**
12. **Julinda Beqiraj, EURALIUS.**
13. **Arlind Maloku, Qendra Evropiane.**
14. **Erion Fejzulla, USAID.**
15. **Ervin Karamuço, ISP.**

#### **RENDI I DITËS:**

6. Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

**Naureda Llagami:** Atëherë, kalojmë në çështjen tjetër, e cila ka të bëjë me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës dhe do relatohet nga kryetari i Komisionit, zoti Ilir Toska.

***Ilir Toska:*** Mirë atëherë, faleminderit!

Janë shumë delegime për këtë mbledhje. Janë 23 gjykata në nevojë dhe mbi 80 kërkesa për caktim gjyqtari për çështje të veçanta.

Paraprakisht do t'ju propozoj për radhën e procedurave të shortit që duhet të ndjekim. Kemi bërë këtë propozim. Fillimisht gjykatat e shkallës së parë sipas kësaj radhe: Gjkata e shkallës së parë sipas juridiksionit të gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm.

Fillimisht gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Tiranë si vijon: Gjkata e Rrethit Gjyqësor Krujë, Gjkata e Rrethit Gjyqësor Mat, Gjkata e Rrethit Gjyqësor Dibër, Gjkata e Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe në fund Gjkata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Durrës, që është vetëm Gjkata e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, që është Gjkata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe më pas Gjkata e Rrethit Gjyqësor Përmet.

Gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin Gjykatës së Apelit Korçë, që është vetëm Gjkata e Rrethit Gjyqësor Pogradec.

Gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Vlorë, fillimisht Gjkata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, më pas Gjkata e Rrethit Gjyqësor Lushnje dhe në fund Gjkata e Rrethit Gjyqësor Berat.

Gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Shkodër, që është vetëm Gjkata e Rrethit Gjyqësor Kukës.

Më pas shorti të vijojë me Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda.

Më pas shorti të vijojë me gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit administrativ sipas kësaj radhe: Gjkata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë, më pas ajo e Shkodrës dhe në fund Gjkata Administrative e Shkallës së Parë Korçë.

Në vijim propozohet që shorti të vijojë me gjykatat e apeleve sipas kësaj radhe: Fillimisht gjykatat e apelit me juridiksion të përgjithshëm, konkretisht Gjkata e Apelit Korçë, Gjkata e Apelit Shkodër, Gjkata e Apelit Gjirokastrë, Gjkata e Apelit Vlorë dhe në fund Gjkata e Apelit Durrës.

Më pas shorti të vazhdojë me Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda, që është edhe e fundit.

Jeni dakord me këtë procedurë shorti/radhë?

**Naureda Llagami:** Dakord?

**Ilir Toska:** Mirë, meqenëse Këshilli është dakord, po vijojmë atëherë me shortet për secilën gjykatë në nevojë.

Shorti i parë që duhet të ndjekim është për **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë**, e cila ka paraqitur nevojë për 7 çështje (5 civile dhe 2 penale). Kërkohet 1 deri në 2 gjyqtarë për çështje të veçanta.

Në këtë rast nuk është i zbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit për shkak të padisponueshmërisë së gjyqtarëve në këtë skemë. Po kështu është i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm, pavarësisht faktit që Gjykata e Krujës ka një pozicion të lirë. Transferimi i një gjyqtari, i deri jo më pak se dy gjyqtarëve do të shkaktonte efekt negativ më të madh se dobia që do të sillte transferimi i tij pranë kësaj gjykate për gjykimin e shtatë çështjeve të veçanta. Duke u bërë kështu i zbatueshëm në këtë rast vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, referuar të cilit Këshilli propozon që gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 7 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 7 (shtatë) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 3.

Në opsionin e pranimit të propozimit si më lart, Komisioni ka propozimin vijues lidhur me hapat e shortit që duhet të ndiqen: Për çështjet penale - për çështjet nr.2 dhe nr.3, për të cilat kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve, ata të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Seksionit Penal të Çështjeve Penale të Themelit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Për çështjet nr.1, nr.4 dhe nr.5, për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, për secilën nga ato, ai të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e caktuar për çështjet nr.2 dhe nr.3, ku në këtë rast, gjyqtari i përzgjedhur për çështjen e përzgjedhur më parë, përjashtohet nga shorti për çështjen tjetër.

2. Sa i përket çështjes civile - Për çështjet nr.6 dhe nr.7, për të cilat kërkohet 1 gjyqtar, ai të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e Seksionit Civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në këtë rast, Komisioni propozon edhe disa përjashtime nga shorti. Kështu propozohet të përjashtohet nga shorti gjyqtarja {...}, që është në Seksionin Penal të Çështjeve Penale të Themelit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për shkak se është me leje lindjeje.

Po kështu propozohet edhe zëvendëskryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë që është në Seksionin Penal, z. {...}.

Të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Seksionit Civil {...}, {...} dhe {...} që kanë pengesë ligjore për çështjet civile.

Të përjashtohet nga shorti gjyqtari {...} që ka pengesë ligjore, që është përjashtuar nga shorti me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Po kështu të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Seksionit Civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të cilët janë caktuar më herët për gjykimin e çështjeve të veçanta në gjykata të tjera të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, që janë: {...} ... {...}. Jeni dakord?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Dakord.

Mirë atëherë, vijojmë me shortin.

Fillojmë shortin me çështjet penale.

Atëherë, për çështjet nr.2 dhe nr.3, për të cilat kërkohet caktimi i 2 gjyqtarë. Do të hedhim në një enë emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë Seksioni Penal i Çështjeve Penale të Themelit që janë: {...} ... {...}.

Do të përzgjedhim emrat e dy prej tyre që do të caktohen për çështjen nr. 2 dhe nr. 3.

{...} është emri i parë dhe {...} është emri i dytë, të cilët caktohen për çështjen nr. 2 dhe nr. 3.

Ndërkohë, për çështjet, 1, 4 dhe 5, pra për çështjet penale 1, 4 dhe 5, do hedhim shortin mes dy gjyqtarëve që u përzgjedhën për çështjen nr. 2 dhe 3. Në një enë do të hedhim numrat 1, 4, 5. Në një enë tjetër emrat e dy gjyqtarëve.



Përzgjidhe një çështje, pastaj emrin e një gjyqtari.

Po, çështja nr. 5. Emri i gjyqtarit të përzgjedhur është – {...}.

Përzgjidh një çështje tjetër.

Çështja nr. 1. Është gjyqtari – {...}.

Dhe për çështjen nr. 4, do të hedhim emrat në enë të dy gjyqtarëve për të përzgjedhur njërin prej tyre – {...}.

Atëherë për çështjen nr. 4 është {...}.

Për çështjen nr. 5 është po gjyqtari {...}.

Për çështjen nr. 1 {...}. 4-a dhe 5-a {...}.

Mbyllet kështu shorti për çështjet penale.

Vazhdojmë me shortin për çështjet civile. Janë çështja 6 dhe 7. Kërkoet 1 gjyqtar. Do të fusim në një enë emrat e gjyqtarëve të Seksionit Civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke hequr gjyqtarët që përjashtuam me vendimin e marrë më parë ({...}, {...} ... {...}). Do të zgjedhim njërin prej tyre që do caktohet për çështjen nr. 6 dhe 7.

Emri i përzgjedhur është {...}.

Me kaq mbyllet procedurat e shortit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat**.

Atëherë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat ka paraqitur nevojë vetëm për 1 çështje. Kërkoet caktimi i një gjyqtari në çështje penale. Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit, ndërsa është i padobishëm mekanizmi i transferimit të përkohshëm, prandaj Komisioni bazuar në vendimin e tij “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, propozon që gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër dhe numri i gjyqtarëve të jetë 1.

Në këtë rast, Komisioni propozon që të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë, zëvendëskryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, zoti {...}.

Jeni dakord?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Mirë, atëherë fusim në një enë emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër që janë: {...}, {...} dhe {...}. Do të përzgjedhim emrin e njërit prej tyre që do të caktohet për të gjykuar çështjen në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat.

Emri i përzgjedhur është {...}.

Me kaq mbyllet procedura e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër (lapsus), me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat.

Dhe fillojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër**. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër ka paraqitur nevojë vetëm për 1 çështje në lëndë penale për caktimin e 1 gjyqtari.

Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit, po kështu është i padobishëm mekanizmi i transferimit të përkohshëm të gjyqtarëve, duke qenë i zbatueshëm vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, referuar të cilit Komisioni propozon që gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat dhe numri i gjyqtarëve të jetë 1, saç është në nevojë. Në këtë rast, Komisioni propozon të përjashtohet nga shorti vetëm kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, zoti {...}, referuar kritereve të përcaktuara në rregulloren tonë.

Jeni dakord?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Dakord.

Mirë atëherë, fusim në një enë emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat që janë: {...}, {...}, {...}.

Mirë atëherë, përzgjedhim emrin e njërit prej tyre.

Edhe {...} që është emri i tretë.

Përzgjedhim emrin e një prej gjyqtarëve.

Është {...}.

Me kaq mbyllet procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin**. Edhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin ka paraqitur nevojë vetëm për 1 çështje (është në lëndë penale). Kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve.

Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit, ndërsa është i padobishëm mekanizmi i transferimit të përkohshëm, duke qenë kështu i aplikueshëm vendimin i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, referuar të cilit Komisioni propozon që gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë të jetë 2. Në këtë rast, sa i përket propozimeve për përjashtimet nga shorti, të përjashtohet nga shorti gjyqtari që do caktohet në rrethin gjyqësor Dibër, -që rezultoi të ishte gjyqtari {...}. Ndërkohë kemi propozuar që në këtë rast, për shkak të afërsisë së gjykatës, të mos përjashtohet nga shorti kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, zoti {...}, për shkak të numrit të kufizuar të gjyqtarëve të kësaj gjykate, nga e cila do duhet të zgjedhim 2 prej tyre për të gjykuar një çështje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin.

Jeni dakord?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Mirë atëherë, do të fusim në një enë emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, që është {...}, {...} dhe {...}. Do të përzgjedhim emrin e njërit prej tyre. Dy prej tyre.

Emri i parë është – {...}.

Emri i dytë është - {...}.

Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë**, që ka paraqitur nevojë në 2 çështje që janë në lëndë civile, ku kërkohet në secilën nga 1 gjyqtar.

Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit, ndërsa është i padobishëm mekanizmi i transferimit të përkohshëm, duke qenë i zbatueshëm vendimin i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të

gjqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, referuar të cilit Komisioni propozon që gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e një çështjeje të veçantë të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë të jetë 1.

Përfundime nga shorti është propozuar vetëm të përjashtohet gjyqtarja {...} e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila ka pengesë ligjore për gjykimin e një prej çështjeve në nevojë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Jeni dakord?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Dakord.

Atëherë, hedhim në një enë emrat e gjyqtarëve të Seksionit Civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, që janë: {...} ... {...}. Kaq janë emrat e gjyqtarëve. Do të përzgjedhim emrat e njërit prej tyre që do caktohen për dy çështje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Emri i përzgjedhur është {...}.

Mbyllet shorti edhe për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Vazhdojmë me gjykatat nën juridiksionin e apelit Durrës që është vetëm **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan**. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka paraqitur nevojë në dy çështje që janë në lëndë civile. Kërkohej 1 dhe 2 gjyqtarë.

Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit, si dhe është i padobishëm mekanizmi i transferimit të përkohshëm, duke qenë kështu i zbatueshëm vendimin i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, ku referuar të cilit Komisioni propozon që gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e dy çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e dy çështjeve gjyqësore të veçanta të jetë 2.

Në opsionin e pranimit të këtij propozimi, Komisioni ka propozim vijues: Për çështjen nr.1 për të cilën kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve, ata të përzgjidhen me short nga Seksionit Civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ndërsa për çështjen nr.2, për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, ai të përzgjidhet me short ndërmjet gjyqtarëve të caktuar për çështjen nr.1.

Në këtë rast kemi paraqitur edhe disa propozime për përjashtim nga shorti. Kemi propozuar të përjashtohet nga shorti gjyqtarja {...} që është caktuar më herët për gjykimin e njëjës prej çështjeve në nevojë. Të përjashtohet nga shorti, siç kemi vendosur më herët për gjyqtarin {...} (e kemi vendosur për një periudhë 6-mujore). Po kështu të përjashtohen nga shorti edhe gjyqtarët e Seksionit Civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë që janë caktuar më herët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, konkretisht gjyqtarët {...} ... {...}, së fundi edhe gjyqtari që caktuar më herët në Gjykatën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, që ishte {...}.

Jeni dakord?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Mirë atëherë, do të hedhim në një enë emrat e gjyqtarëve, duke hequr ata që përjashtuam. Janë {...} ... {...}. Do përzgjedhim dy prej tyre që do caktohen për çështjen nr. 1.

Emri i parë i përzgjedhur është {...}.

Emri i dytë është {...}.

Do bëjmë short mes këtyre dy gjyqtarëve, që do caktohet për çështjen nr. 2, e cila kërkon vetëm 1 gjyqtar.

Do të fusim në një enë emrat e dy gjyqtarëve {...} dhe {...}. Do zgjedhim njërin prej tyre.

Është {...}, që caktohet për çështjen nr. 2.

Me kaq mbyllet shorti për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Vazhdojmë me gjykatën nën juridiksionit në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, fillimisht me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë**. Ka paraqitur nevojë vetëm për 1 çështje, që është në lëndë civile. Kërkohet vetëm 1 gjyqtar. Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit, si dhe i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit

të përkohshëm, duke qenë i aplikueshëm vendimin i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, referuar të cilit Komisioni propozon që gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe numri i gjyqtarëve të jetë 1.

Në opsionin e pranimi të këtij propozimi, kemi disa propozime për përjashtim nga shorti, që është vetëm për kryetarin në detyrë, zëvendëskryetarin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, zotin {...}.

Në parim kemi përcaktuar në rregullore që mund të përjashtohen nga shorti. Bëhet fjalë për një çështje. Nëse s’doni, votoni kundër këtij propozimi. Nëse doni, atëherë.

Mirë, meqenëse Këshilli është dakord me propozimet.

Do të hedhim në një enë emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, që janë {...} ... {...}. Do të përzgjedhim emrin e njërit prej tyre.

{...}, caktohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë për një çështje. Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjjirokastrën.

Vazhdojmë me procedurat e shortit për **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet**. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet, ka paraqitur nevojë në 5 çështje, të cilat janë në lëndë penale, në një prej të cilave kërkohen dy gjyqtarë.

Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit, si dhe i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm, duke qenë kështu i aplikueshëm vendimin i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, referuar të cilit Komisioni propozon që gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 5 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 5 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 3.

Në opsionin e pranimi të propozimit si më lart, për hapat e shortit, Komisioni ka propozimin vijues: Për çështjen nr.3, për të cilën kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve, ata të përzgjidhen, me short, nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

Për çështjet nr.1 dhe nr.2, për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, ai të përzgjidhet, me short, nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë të caktuar për çështjen nr.3, ku në këtë rast, gjyqtari i përzgjedhur për çështjen e përzgjedhur më parë, përjashtohet nga shorti për çështjen tjetër.

Për çështjet nr.4 dhe nr.5, për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, ai të përzgjidhet, me short, nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, ku në këtë rast, gjyqtari i përzgjedhur për çështjen e përzgjedhur më parë, përjashtohet nga shorti për çështjen tjetër.

Kemi propozime për përjashtim nga shorti. Për çështjen nr. 3 duhet të përjashtohet nga shorti gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, {...}, që është caktuar më herët për gjykimin e kësaj çështjeje. Po kështu përjashtohet nga shorti edhe kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, {...} si dhe ai i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, zoti {...}.

Jeni dakord?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Mirë, meqenëse Këshilli është dakord, vijojmë me procedurat e shortit. Fillimisht për çështjen nr. 3 për të cilën kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve. Do të hedhim në një enë emrat e gjyqtarëve, duke përjashtuar gjyqtaren {...} që ka pengesë për këtë çështje për shkak se është e caktuar më herët. Emrat e tjerë janë {...}, {...} dhe {...}. Do të përzgjedhim 2 prej tyre që të caktohen për çështjen nr. 3.

{...} është emri i parë dhe {...} është emri i dytë që caktohen për çështjen nr. 3.

Ndërkohë, për çështjen 1 dhe 2 do duhet të zhvillojmë short mes këtyre dy gjyqtareve. Do të hedhim në një enë emrat e gjyqtarëve {...} dhe {...} dhe në një enë tjetër, numrat 1 dhe 2.

Do të përzgjedhim numrin e parë - që është numri 2.

Do të përzgjedhim emrin e gjyqtarit për këtë – është {...}.

Kështu që, për çështjen nr.1, mbetet gjyqtarja {...}.

Do të vijojmë shortin për çështjen nr. 4 dhe nr. 5 për të cilat do të zgjedhim 1 gjyqtar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Do të fusim në një enë emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, duke përjashtuar kryetarin në detyrë. Emrat e tjerë janë: {...} ... {...}.

Do të përzgjedhim njërin prej tyre. Emri i përzgjedhur është {...}, që caktohet për çështjen nr. 4 dhe nr. 5. Me kaq mbyllen procedurat e shortit.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec**, që është nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Korçë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec ka paraqitur nevojë në 3 çështje, 1 në lëndë civile dhe 2 në lëndë penale. Kërkohet caktimi i 1 gjyqtari në secilën prej tyre.

Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm zbatimi i mekanizmit të skemës së delegimit, duke qenë i padobishëm ndërkohë edhe zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm, çka bën të aplikueshëm vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, referuar të cilit Komisioni propozon që gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta të jetë 2. Në opsionin e pranimit të këtij propozimi, Komisioni ka propozimin vijues, që konsiston që për 3 çështje për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, të caktohen dy gjyqtarë të cilët të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, ku në këtë rast, gjyqtari i përzgjedhur për çështjen e përzgjedhur më parë, përjashtohet nga shorti për çështjen e përzgjedhur e dyta. Për çështjen tjetër që mbetet, gjyqtarët përzgjidhen me short midis dy gjyqtarëve të përzgjedhur për dy çështjet e para.

Kemi propozim për përjashtim nga shorti. Për kryetaren në detyrë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, {...}. Të përjashtohen po ashtu gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, të cilët janë caktuar më herët për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin, që janë: zoti {...} ... {...}. Po kështu të përjashtohet nga shorti – pak më herët vendosëm që të miratojmë komandimin e gjyqtarës {...}. Po kështu për çështjen nr. 1 duhet të përjashtohen nga shorti edhe gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë që janë caktuar më herët për gjykimin e çështjeve të tjera mes të njëjtave palë ndërgjyqëse, që janë: {...} dhe {...}.

Jeni dakord me këto propozime?

Dakord.



Atëherë, do të hedhim në një enë emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, duke hequr ata që vendosëm t'i përjashtojmë nga shorti. Emrat e tjerë janë: {...} ... {...}. Do të hedhim në një enë numrat 1, 2, 3 të çështjeve. Përzgjidhet një numër çështjeje dhe pastaj përzgjidhet një emër gjyqtari.

Numri 2 është i pari dhe do përzgjedhim emrin e një gjyqtari – {...}.

3-shi – {...}.

Dhe 1-shi mbetet {...}.

Me kaq mbyllen procedurat për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec.

Vazhdojmë me gjykatat nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Vlorë. Fillimisht për **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë**. Ka paraqitur nevojë për 1 çështje penale. Kërkoheft caktimi i 1 gjyqtari.

Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit, po kështu është i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm, duke qenë i aplikueshëm vendimin i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, referuar të cilit Komisioni propozon që gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohet për 1 çështje, të jetë 1.

Në rast të pranimit të opsionit më lart, kemi disa propozime për përjashtim nga shorti. Përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, zoti {...}. Po kështu, kemi propozuar paraprakisht, zonja {...}, që pak më herët vendosëm komandimin e saj pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor. Gjithsesi mbetet që propozimi ta konsideroni.

Jeni dakord me propozimet?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Dakord.

Mirë atëherë, hedhim në një enë emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, që janë: {...} ... {...}.

Mirë atëherë, vijojmë procedurën e shortit. Kemi hedhur në një enë emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat dhe do të përzgjedhim emrin e njërit prej tyre – Është {...}.

Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnje**. Paraqitet nevojë vetëm për 1 çështje, që është në lëndë penale. Kërkohet caktimi i 1 gjyqtari. Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit, si dhe i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm, duke qenë i aplikueshëm vendimin i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, referuar të cilit Komisioni propozon që gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat dhe numri i gjyqtarëve të jetë 1.

Edhe në këtë rast, Komisioni ka të njëjtin propozim, për përjashtimin e zëvendëskryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, zotit {...} si dhe të gjyqtares që do caktohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, që më herët ishte zonja {...}.

Jeni dakord me propozimet?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Dakord.

Mirë atëherë, hedhim në një enë emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat që janë: {...} ... {...}. Do të përzgjedhim emrin e njërit prej tyre – që është {...}, e cila caktohet për 1 çështje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnje. Mbyllen procedurat e shortit për Lushnjën.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat**. Edhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat ka paraqitur nevojë vetëm për 1 çështje, që është në lëndë penale. Kërkohet caktimi i 1 gjyqtari.

Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit, si dhe i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm, duke qenë kështu i aplikueshëm vendimin i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, referuar të cilit

Komisioni propozon që gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnje dhe numri i gjyqtarëve të jetë 1.

Në opsionin e pranimit të këtij propozimi kemi propozim për përjashtimin nga shorti vetëm të kryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, zonja {...}. Jeni dakord?

{...} është me leje lindjeje. Jeni dakord?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Dakord.

Mirë atëherë, hedhim në një enë emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, që janë: {...} (u përjashtua), {...} ... {...}. Do të përzgjedhim emrin e njërit prej tyre – {...} do të shkojë në Berat. Me kaq mbyllet procedura e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat.

Vazhdojmë me procedurat e shortit për gjykatat nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Shkodër, që është vetëm **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës**, që ka paraqitur nevojë vetëm për 1 çështje në lëndë penale. Kërkohet caktimi i 1 gjyqtari.

Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit, si dhe i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm, duke qenë kështu i aplikueshëm vendimin i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, referuar të cilit Komisioni propozon që gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen, të jetë 1.

Në rast të pranimit të këtij propozimi, kemi propozuar që të mos përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë zëvendëskryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, zoti {...}, për shkak të numrit të kufizuar të gjyqtarëve në këtë gjykatë dhe numrit të ulët të çështjeve nga ana tjetër, që ka Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë. Jeni dakord?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Dakord.

Mirë atëherë, hedhim në një enë emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë që janë: {...}, {...} dhe {...}. Duhet të përzgjedhim emrin e njërit prej tyre që duhet të gjykojë 1 çështje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës.

Emri i përzgjedhur është {...}.

Me kaq mbyllet procedura e shortit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës.

Vazhdojmë me procedurat e shortit për **Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda**. Ka paraqitur nevojë për 3 çështje. Kërkohet nga 1 dhe 3 gjyqtarë.

Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit, si dhe i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm, duke qenë kështu i aplikueshëm vendimin i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, referuar të cilit Komisioni propozon që gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 3.

Në opsionin e pranimit të propozimit si më lart, duke pasur në konsideratë numrin e gjyqtarëve që kërkohen të caktohen për secilën çështje, formimin më herët të trupave gjykues për çështjet në nevojë për caktim gjyqtari, si dhe për ekonomizim të burimeve njerëzore referuar pikës 4 të Kreut VII të Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, për hapat e shortit që duhet të ndiqen, Komisioni propozon që:

Për çështjen nr.2, për të cilën kërkohen 3 gjyqtarë, ata të përzgjidhen nga gjyqtarët e Seksionit Penal të Çështjeve Penale të Themelit, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në këtë rast, si të përzgjedhur nga shorti të konsiderohen 2 gjyqtarët e Seksionit Penal të Çështjeve Penale të Themelit, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që janë përzgjedhur me shortin e datës 08.10.2019 dhe caktuar për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, konkretisht gjyqtarët {...} dhe {...}. Për gjyqtarin e tretë, ai të përzgjidhet, me short, nga gjyqtarët e tjerë të Seksionit Penal të Çështjeve Penale të Themelit, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Për çështjet nr.1 dhe nr.3, për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, për secilën nga ato, ai të përzgjidhet me short midis gjyqtarëve të caktuar për çështjen nr.2, ku gjyqtari i përzgjedhur për çështjen e përzgjedhur më parë, përjashtohet nga shorti për çështjen tjetër.

Edhe në këtë rast kemi propozuar disa propozime nga shorti, që janë: zonja {...} që është me leje lindjeje, zoti {...} që është kryetar në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, njëherazi dhe gjyqtar në Seksionin Penal të kësaj gjykate.

Jeni dakord me propozimet?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Dakord.

Mirë atëherë, meqenëse propozimet u pranuan. Për çështjen nr.2, për të cilën kërkohen 3 gjyqtarë, dy gjyqtarët konsideruam që janë ata të përzgjedhur në shortin e para pak ditëve (ata të shortit të datës 8), që janë gjyqtarët {...} dhe {...}. Do duhet të përzgjedhim edhe 1 gjyqtar tjetër. Do të fusim në një enë emrat e gjyqtarëve të Seksionit Penal të Çështjeve Penale të Themelit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë që janë: {...} ... {...} ...

{...} dhe {...} ishin gjyqtarët që caktuam pak më herët në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë, -a mendoni që duhet t'i propozojmë, mos t'i caktojmë njëherazi në dy gjykata? Sa i caktuam në 5 çështjet në Krujë. Jeni dakord?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Dakord.

Duhet të përjashtojmë atëherë gjyqtarët {...} dhe {...}.

Dhe {...} është emri i fundit. *(që futet në enë)*

Duhet të përzgjedhim njërin prej tyre.

Emri i përzgjedhur është {...}, që caktohet bashkë me gjyqtarët {...} dhe {...} për çështjen nr. 2.

Do të bëjmë procedurat e shortit për çështjen nr. 1 dhe nr.3 mes 3 gjyqtarëve.

Në një enë do të hedhim nr. 1 dhe nr. 3 dhe në enën tjetër emrat e 3 gjyqtarëve {...}, {...} dhe {...}.

Atëherë, përzgjedhim një numër. Numri i parë është 3. Do të përzgjedhim emrin e një gjyqtari – që është {...}.

Dhe çështja nr. 1, do të përzgjedhim emrin e një gjyqtari – që është {...}.

Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda.

Vazhdojmë me gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit administrativ. Fillimisht është **Gjykata e Shkallës së Parë Gjirokastrë**. Ka paraqitur nevojë për 14 çështje. Për të gjitha ato kërkohet caktimi i 1 gjyqtari.

Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit, si dhe i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm, duke qenë i aplikueshëm vendimin i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, referuar të cilit Komisioni propozon që gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 14 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jenë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 14 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 3. Në rast të pranimit të propozimit si më lart, për hapat e shortit, Komisioni propozon: Për 14 çështjet, për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, të caktohen 3 gjyqtarë, duke u përzgjedhur ata me short, nga gjyqtarët e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, nga secila 1 gjyqtar.

Për 14 çështje, në të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, për secilin grup çështjesh, grupin e parë që përfshin çështjet nr.1, nr.2, nr.3, nr.4 dhe nr.5, grupin e dytë që përfshin çështjet nr.6, nr.7, nr.8 dhe nr.9, si dhe grupin e tretë që përfshin çështjet nr.10, nr.11, nr.12, nr.13 dhe nr.14, gjyqtari të përzgjidhet, me short, midis 3 gjyqtareve të përzgjedhur sipas pikës 1. Në këtë rast, gjyqtari i përzgjedhur për grupin e çështjeve të përzgjedhura të parat, përjashtohet nga përzgjedhja për grupin tjetër të çështjeve.

Nëse pranohet ky propozim, kemi disa propozime për përjashtim nga shorti që janë: përjashtimin e kryetarëve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe Vlorë, zotit {...} dhe zotit {...}. Po kështu të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të cilët janë caktuar më herët për gjykimin e katër apo më shumë çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, që janë {...} ... {...}.

Kemi propozim të mos përjashtohet nga shorti kryetari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, zoti {...}, për shkak të numrit të kufizuar të gjyqtarëve në këtë gjykatë si dhe numrit të kufizuar të çështjeve. Jeni dakord?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Dakord.

Mirë atëherë, do të hedhim në një enë tre grupet e çështjeve. Grupi i parë ka çështjet nr. 1-5, grupi i dytë ka çështjet nr. 6-9 dhe numri i tretë ka çështjet nr. 10-14.

Ndërkohë do të bëjmë procedurat e shortit për përzgjedhjen e një gjyqtari, fillimisht nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë. Do të hedhim në një enë emrat e gjyqtarëve të kësaj gjykate, duke përjashtuar ata që vendosëm përjashtimin. Emrat që do futen në enë janë: {...} ... {...}. Do të përzgjedhim emrin e njërit prej tyre. Është {...}.

Tani do të përzgjedhim një gjyqtar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë. Do të fusim në një enë emrat e gjyqtarëve të kësaj gjykate, për të përzgjedhur emrin e njërit prej tyre. Emrat janë {...} ... {...}. Do të përzgjedhim emrin e njërit prej tyre. Është {...}.

Ndërkohë do të fusim në një enë emrat e gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, për të përzgjedhur njërin prej tyre. Emrat që do futen në enë janë {...} dhe {...}. Do të përzgjedhim emrin e njërit prej tyre. Është {...}.

Atëherë, emrat e përzgjedhur nga tre gjykata që janë {...}, {...} dhe {...} do t'i hedhim në një enë dhe për secilin grup çështjesh që kemi hedhur në enën tjetër, do të zgjedhim emrin e një gjyqtari.

Zgjedhim më parë grupin e çështjeve.

Grupi i përzgjedhur është 1, 2, 3, 4, dhe 5. Do të përzgjedhim emrin e një gjyqtari – që është {...}.

Përzgjedhim grupin e dytë të çështjeve, që është 10, 11, 12, 13 dhe 14. Emri i gjyqtarit të përzgjedhur i dyti është – {...}.

Dhe grupi i tretë i çështjeve është 6, 7, 8, 9 që mbetet për gjyqtaren {...}.

Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë.

Vazhdojmë me **Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër**. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër ka paraqitur nevojë në 5 çështje, ku kërkohen në tre prej tyre 2 gjyqtarë dhe në dy nga 1 gjyqtar.

Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit, si dhe i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm, duke qenë kështu i aplikueshëm vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, referuar të cilit Komisioni propozon që gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 5 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohet për gjykimin e 5 çështjeve gjyqësore të jetë 2.

Në opsionin e pranimit të këtij propozimi, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon që për çështjet 1, 3 dhe 4, për të cilat kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve, ata të përzgjidhen, me short, midis gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ndërsa për çështjet nr.2 dhe nr.5, për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, për secilin nga ato, gjyqtari të përzgjidhet midis 2 gjyqtarëve të caktuar për çështjet sipas pikës 1.

Në këtë rast kemi propozuar përjashtimin nga shorti për kryetarin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, zoti {...}. Për gjyqtarët e kësaj gjykate që kanë gjykuar dhe janë caktuar më herët për gjykimin e 4 apo më shumë çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, që janë gjyqtarët {...} ... {...}. Po kështu të përjashtohet nga shorti edhe gjyqtari që u caktua në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, që më herët ishte {...}.

Jeni dakord.

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Dakord.

Atëherë hedhim në një enë emrat e gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë: {...} ... {...}. Do të përzgjedhim dy prej tyre të cilët do të caktohen për çështjet nr. 1, 3 dhe 4.



Emri i parë i përzgjedhur është – {...}.

Dhe emri i dytë i përzgjedhur është – {...}.

Atëherë, për çështjen nr. 2 dhe nr. 5 do të bëjmë një short mes gjyqtarës {...} dhe {...}. Hedhim në një enë emrat e dy gjyqtarëve, ndërsa në enën tjetër çështjet nr. 2 dhe nr. 5. Fillimisht do të zgjedhim çështjen, pastaj do të zgjedhim emrin e gjyqtarit.

Çështja e përzgjedhur e para është ajo me nr. 2. Përzgjedhim edhe gjyqtarin për këtë çështje - Është {...}.

Kështu që i bie për çështjen nr. 5 të jetë gjyqtarja {...}.

Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.

Vazhdojmë me **Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë**, që ka paraqitur nevojë për 1 çështje. Kërkohet caktimi i 1 gjyqtari.

Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit, si dhe i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm, duke qenë i aplikueshëm vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, referuar të cilit Komisioni propozon që gjykata nga duhet të përzgjidhen, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë të jetë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë dhe numri i gjyqtarëve të jetë 1, saç është në nevojë.

Në këtë rast kemi propozuar që të mos përjashtohet nga shorti kryetari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, zoti {...} për shkak të numrit të kufizuar të gjyqtarëve të kësaj gjykate si dhe numrit të kufizuar të çështjeve pranë saj.

Jeni dakord?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Dakord.

Atëherë, do të fusim në një enë emrat e gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, për të përzgjedhur njërin prej tyre. Emrat janë {...} dhe {...}.

Do të përzgjedhim emrin e njërit prej tyre që të caktohet në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë.

Emri i përzgjedhur është {...}.

Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë.

Vazhdojmë me gjykatat e apelit. Fillimisht është **Gjykata e Apelit Korçë**, e cila ka paraqitur nevojë në 16 çështje, nga të cilat 12 në lëndë penale dhe 4 në lëndë civile. Kërkohej nga 1 deri në 3 gjyqtarë.

Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit dhe i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm, duke qenë i aplikueshëm vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, referuar të cilit Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon që gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 16 çështjeve gjyqësore të veçanta të jenë Gjykata e Apelit Tiranë, Gjykata e Apelit Durrës dhe Gjykata e Apelit Vlorë. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 16 çështjeve gjyqësore të veçanta të jetë 7 (3 gjyqtarë nga Gjykata e Apelit Tiranë, 2 gjyqtarë nga Gjykata e Apelit Durrës dhe 2 gjyqtarë nga Gjykata e Apelit Vlorë).

Në opionin e pranimit të propozimit si më lart, Komisioni ka këto propozime vijuese. Për çështjet penale: Për 6 çështjet e para penale, ato nr.1, nr.2, nr.3, nr.4, nr.5 dhe nr.6, të caktohen 3 gjyqtarë, të cilët të përzgjidhen, me short, nga Seksioni Penal i Gjykatës së Apelit Tiranë dhe konkretisht: Për çështjen nr.2, për të cilën kërkohej caktimi i 3 gjyqtarëve, ata të përzgjidhen me short midis gjyqtarëve të Seksionit Penal të Gjykatës së Apelit Tiranë. Në këtë rast, gjyqtari i përzgjedhur i pari caktohet edhe si relator i çështjes.

Për çështjet nr.1, nr.5 dhe nr.6, për të cilat kërkohej caktimi i 2 gjyqtarëve, për secilën nga ato, gjyqtarët të përzgjidhen me short midis atyre të caktuar për çështjen nr.2. Në rast se për çështjen nr.6 nga shorti përzgjidhet gjyqtarja {...}, e cila është e caktuar më herët në përbërje të trupit gjykues, atëherë, për këtë çështje, si të përzgjedhur nga shorti konsiderohen dy gjyqtarët e tjerë të caktuar për çështjen nr.2.

Për çështjet nr.3 dhe nr.4, për të cilat kërkohej caktimi i 1 gjyqtari, për secilën nga ato, ai të përzgjidhet me short midis 2 gjyqtarëve të caktuar si anëtar për çështjen nr.2. Në këtë rast, gjyqtari i përzgjedhur për çështjen e përzgjedhur e para, përjashtohet nga shorti për çështjen tjetër. Në rast se për çështjen nr.3 nga shorti përzgjidhet gjyqtari {...}, i cili është i

caktuar më herët në përbërje të trupit gjykues, atëherë, për këtë çështje, gjyqtari përzgjidhet me short midis dy gjyqtarëve të tjerë të caktuar për çështjen nr.2.

Për 6 çështjet e dyta penale, ato nr.7, nr.8, nr.9, nr.10, nr.11 dhe nr.12, të caktohen 2 gjyqtarë, të cilët të përzgjidhen, me short, nga Gjykata e Apelit Durrës dhe konkretisht:

Për çështjet nr.7, nr.8, nr.10 dhe nr.11, për të cilat kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve, ata të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës.

Ndërsa për çështjet nr.9 dhe nr.12, për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, për secilën nga ato, gjyqtari të përzgjidhet midis gjyqtarëve të caktuar për çështjet nr.7, nr.8, nr.10 dhe nr.11. Në këtë rast, gjyqtari i përzgjedhur për çështjen e përzgjedhur e para, përjashtohet nga shorti për çështjen tjetër.

Për çështjet civile: Për 4 çështjet civile, të caktohen 2 gjyqtarë, të cilët të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë dhe konkretisht:

Për çështjet nr.13 dhe nr.16, për të cilat kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve, ata të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë.

Ndërsa për çështjet nr.14 dhe nr.15, për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, për secilën nga ato, gjyqtari të përzgjidhet midis gjyqtarëve të caktuar për çështjet nr.13 dhe nr.16. Në këtë rast, gjyqtari i përzgjedhur për çështjen e përzgjedhur e para, përjashtohet nga shorti për çështjen tjetër. Në rast se për çështjet sipas pikës 1 nga shorti përzgjidhen gjyqtarët {...} dhe {...}, atëherë për çështjen nr.14, gjyqtari përzgjidhet nga gjyqtarët e tjerë të Gjykatës së Apelit Vlorë.

Gjyqtarët {...} dhe {...} kanë pengesë apo janë të caktuar për çështjen nr. 14.

Referuar propozimeve si më lart, kemi disa propozime për përjashtim nga shorti.

Propozimi i parë është për përjashtimin e gjyqtarëve {...} dhe {...}, që janë gjyqtarë të seksionit penal të Gjykatës së Apelit Tiranë, të cilët kanë depozituar kërkesë për dorëheqje nga statusi i magjistratit.

Për çështjen penale nr.3 të përjashtohet nga shorti gjyqtari {...} i Seksionit Penal të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Për çështjen nr. 6 të përjashtohet nga shorti gjyqtarja {...} që është e Seksionit Penal të Gjykatës së Apelit Tiranë që është e caktuar më herët për gjykimin e kësaj çështjeje.

Për 6 çështjet të dyta penale të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës së Apelit Durrës, zoti {...}.

Po kështu në shortimin e 6 çështjeve të dyta penale te përjashtohet nga shorti gjyqtari i Gjykatës së Apelit Durrës, që është caktuar më herët për gjykimin e 10 apo më shumë çështjeve gjyqësore në gjykata të tjera të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, që është zoti {...}.

Në shortimin e çështjeve civile të përjashtohet nga shorti kryetarja në detyrë, zëvendëskryetarja e Gjykatës së Apelit Vlorë, zonja {...}.

Dhe për çështjen 14, siç referova më lart të përjashtohen nga shorti gjyqtarët {...} dhe {...}, që kanë pengesë ligjore apo janë caktuar më herët në përbërje të trupit gjykues.

Jeni dakord me propozimet?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Dakord.

Vazhdojmë atëherë procedurat e shortit.

Fillimisht për 6 çështjet e para penale që Këshilli ra dakord që të caktohen tre gjyqtarë që të përzgjidhen nga Seksioni Penal i Gjykatës së Apelit Tiranë.

Atëherë, për çështjen nr. 2 për të cilën kërkohet caktimi i 3 gjyqtarëve, do të përzgjedhim nga Seksioni Penal i Gjykatës së Apelit Tiranë. Do të fusim në një enë emrat e gjyqtarëve, duke përjashtuar ata që vendosëm përjashtimin e tyre. Janë: {...} ... {...}. Do të përzgjedhim emrat e 3 prej tyre. I pari është edhe relator për çështjen nr. 2.

Emri i parë është {...}, që është edhe relator për çështjen nr. 2.

Emri i dytë është {...}.

Dhe emri i tretë është {...}.

Për çështjen 1, 5 dhe 6 për të cilën kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve, do t'i përzgjedhim ata mes gjyqtarëve të caktuar për çështjen nr. 2, pra mes 3 gjyqtarëve.

Do të hedhim në një enë emrat e gjyqtarëve.

Në një enë do të hedhim çështjet 1, 5 dhe 6.

Atëherë, mund të zgjedhësh një çështje.

Çështja e përzgjedhur e para është me nr. 5. Do të përzgjedhim emrat e dy gjyqtarëve. Emri i parë është – {...} dhe emri i dytë – {...}.

Po, futi përsëri emrat e gjyqtarëve në enë.

Do të përzgjedhim çështjen tjetër.

Çështja tjetër është me nr. 1. Do të përzgjedhim emrat e dy gjyqtarëve nga tre që kemi përzgjedhur më parë. Emri i parë është – {...} dhe emri i dytë {...}.

Kemi dhe çështjen e fundit, çështjen nr. 6.

Për çështjen nr. 6 është e përjashtuar nga shorti gjyqtarja {...}, kështu që automatikisht janë {...} dhe {...}.

Pra, për çështjet 1, 5 dhe 6 caktohen 2 gjyqtarët që janë {...} dhe {...}.

Kemi procedurat e shortit për çështjen nr. 3 dhe 4 për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari.

Do të fusim në këtë rast përsëri emrat e tre gjyqtarëve në një enë dhe në një enë tjetër numrat 3 dhe 4. Do të zgjedhim njëren çështje.

Çështja e përzgjedhur e para është ajo me nr. 4. Do të përzgjedhim emrin e një gjyqtari – që është {...}.

Çështja tjetër është çështja nr. 3. Në këtë rast është automatikisht i përzgjedhur gjyqtari {...}, për shkak se gjyqtari {...} është i caktuar për çështjen nr. 3. Kështu që mbyllet procedura e shortit për 6 çështjet e para penale në Gjykatën e Apelit Korçë.

Vazhdojmë procedurat e shortit për 6 çështjet e dyta penale, ato 7, 8, 9, 10, 11 dhe 12 që do caktojmë dy gjyqtarë nga Gjykata e Apelit Durrës. Fusim në një enë emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Durrës, duke përjashtuar kryetarin në detyrë {...} dhe gjyqtarin {...} që është caktuar në më shumë se 10 çështje. Emrat e tjerë do t'i fusim në një enë, janë: {...} ... {...}. Do të përzgjedhim dy prej tyre të cilët do caktohen për çështjet 7, 8, 10 dhe 11, për të cilat kërkohet caktimi i dy gjyqtarëve.

Emri i parë i përzgjedhur është – {...} dhe emri i dytë është – {...}. Këta caktohen për çështjet 7, 8, 10, 11.

Do të vijojmë procedurat për... Për çështjet 9 dhe 12, për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, do të bëjmë procedurat e shortit midis dy gjyqtarëve që zgjedhëm më herët, që janë: {...} dhe {...}. Do të fusim në një enë numrat 9 dhe 12 dhe në enën tjetër emrat e dy gjyqtarëve.

Përzgjedhim çështjen e parë - është nr. 12.

Përzgjedhim emrin e gjyqtarit – që është {...}.

Mbetet çështja nr. 9 që i përket emrit të gjyqtares {...}.

Mbyllen kështu procedurat e shortit për 6 çështjet e dyta penale të Gjykatës së Apelit Korçë.

Vazhdojmë procedurat e shortit për çështjet civile, për të cilat ramë dakord që të caktohen dy gjyqtarë të cilët do të përzgjidhen me short nga Gjykata e Apelit Vlorë.

Atëherë, hedhim në një enë emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Vlorë, duke përjashtuar emrin e kryetares në detyrë {...} dhe do të mbajmë në konsideratë që për çështjen nr. 14 ka pengesë ligjore gjyqtarët {...} dhe {...}.

Atëherë, fusim emrat e tjerë të Gjykatës së Apelit Vlorë, që janë: {...}...

Do duhet të përjashtojmë edhe... kemi marrë vendim për përjashtimin nga shorti të anëtares së KED-së që është njëherazi edhe gjyqtare e Gjykatës së Apelit Vlorë, që është {...}.

Vijojmë me emrat. Emri i parë ishte {...}, emri i dytë është {...}, emri i tretë {...}, emri i katër {...}, emri i pestë {...} dhe i fundit {...}.

Atëherë, do të zgjedhim 2 prej tyre që t'i caktojmë për çështjen nr. 13 dhe nr. 16. Emri i parë është {...} dhe emri i dytë është {...}.

Vazhdojmë procedurat e shortit për çështjen nr. 14 dhe nr. 15 për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, për secilën nga ato, ato të përzgjidhen nga gjyqtarët e caktuar për çështjen... Në një enë do të hedhim emrat e gjyqtarëve {...} dhe {...}. Në enën tjetër do të hedhim numrat e çështjeve 14 dhe 15.

Atëherë, për çështjen 14, gjyqtari {...} ka pengesë. Kështu që, automatikisht për çështjen nr. 14 i bie të jetë gjyqtari {...}.

Do të bëjmë procedurë shorti vetëm për çështjen nr. 15 mes gjyqtarëve {...} dhe {...}. Emri i përzgjedhur është {...}.

Pra për çështjen 14 dhe 15 që kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, caktohet gjyqtari {...}.

Me kaq mbyllet procedura e shortit për Gjykatën e Apelit Korçë.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Apelit Shkodër**. Ka paraqitur nevojë për 2 çështje (1 në lëndë penale dhe 1 në lëndë civile). Kërkohet caktimi i 1 gjyqtari.

Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit si dhe i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm, duke qenë i aplikueshëm vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo

ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, referuar të cilit Komisioni propozon që gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta të jetë Gjykata e Apelit Durrës dhe numri i gjyqtarëve të jetë 1.

Në opsionin e pranimit të propozimit si më lart, kemi propozim të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës së Apelit Durrës, {...}. Të përjashtohet nga shorti gjyqtari që u caktua në Gjykatën e Apelit Korçë, që ishin gjyqtarët {...} dhe {...}. Po kështu të përjashtohet nga shorti gjyqtari {...} që është caktuar në 10 apo më shumë çështje gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionet në mënyrë të përhershme. Jeni dakord?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Dakord.

Atëherë, hedhim në një enë emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Durrës, që nuk janë përjashtuar nga shortimi, që janë: {...}, {...}, {...}.

Atëherë, do të përzgjedhim njërin prej tyre që do të caktohet për 2 çështje në nevojë në Gjykatën e Apelit Shkodër. Emri i përzgjedhur është {...}.

Me kaq mbyllet procedurat e shortit për Gjykatën e Apelit Shkodër.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Apelit Gjirokastër**. Gjykata e Apelit Gjirokastër ka paraqitur nevojë për 5 çështje (2 në lëndë penale ku kërkohen 3 gjyqtarë dhe 3 në lëndë civile ku kërkohet 1 dhe 2 gjyqtarë).

Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit dhe i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm, duke qenë i aplikueshëm vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, referuar të cilit Komisioni propozon që gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 5 çështjeve gjyqësore të veçanta të jenë Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda dhe Gjykata e Apelit Korçë. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 5 çështjeve gjyqësore të veçanta të jetë 5.

Në rast të pranimit të propozimit si më lart, për hapat e shortit, Komisioni ka këto propozime vijuese. Për çështjet penale pra për çështjet nr.1 dhe nr.2, për të cilat kërkohet

caktimi i 3 gjyqtarëve, ata të përzgjidhen, me short, midis gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda. Në këtë rast, gjyqtari i përzgjedhur i pari caktohet automatikisht si relator i çështjes nr.1, ndërsa ai i përzgjedhur i dyti caktohet automatikisht si relator për çështjen nr.2.

Për çështjet civile, për çështjet nr.4 dhe nr.5, për të cilat kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve, ata të përzgjidhen, me short, midis gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Korçë.

Për çështjen nr.3, për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, ai të përzgjidhet me short midis 2 gjyqtarëve të caktuar sipas pikës 1.

Në këtë rast, kemi propozime për përjashtime nga shorti. Për kryetarin në detyrë të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda dhe asaj të Gjykatës së Apelit Korçë, pra për gjyqtarët znj. {...} dhe {...}. Jeni dakord?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Dakord.

Vijojmë procedurat atëherë. Fillimisht për çështjet penale, çështjen nr. 1 dhe nr. 2. Do të hedhim në një enë emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, që janë {...} ... {...}. Do të përzgjedhim emrat e tre prej tyre, ku emri i parë është relator për çështjen nr. 1, emri i dytë është relator për çështjen nr. 2.

Atëherë, emri i parë është {...}, që caktohet edhe si relatore për çështjen nr. 1. Emri i dytë është {...} që caktohet si relatorë për çështjen nr. 2. Emri i tretë është {...} që caktohet anëtare për çështjen nr. 1 dhe nr. 2, bashkë me dy gjyqtaret e përzgjedhura më parë.

Vazhdojmë me çështjet civile. Fillimisht për çështjen 4 dhe 5. Do duhet të përzgjedhim 2 gjyqtarë nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Korçë. Do të hedhim në një enë emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Korçë që janë: {...}, {...} dhe {...}. Do të zgjedhim 2 prej tyre që do caktohen për çështjen 4 dhe 5.

Emri i parë i përzgjedhur është {...}. Emri i dytë është {...}.

Për çështjen nr. 3 do duhet të bëjmë short mes dy gjyqtarëve si më lart, se çështja nr. 3 kërkon caktimin e 1 gjyqtari.

Emri i përzgjedhur është {...} që caktohet për çështjen nr. 3.

Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Apelit Gjirokastrë.

Vazhdojmë me **Gjykatën e Apelit Vlorë**. Gjykata e Apelit Vlorë ka paraqitur nevojë në 4 çështje, që janë të katra në lëndë penale. Kërkohet 1 dhe 2 gjyqtarë.



Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit dhe i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm, duke qenë i aplikueshëm vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, referuar të cilit Komisioni propozon që gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 4 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit e Apelit Gjirokastër dhe Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 4 çështjeve gjyqësore të veçanta të jetë 3 (1 gjyqtar nga Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda dhe 2 gjyqtarë nga Gjykata e Apelit Gjirokastër).

Në opsionin e pranimit të propozimit si më lart, ndërsa gjyqtarët duhet të caktohen nga dy gjykata apeli, duke patur në konsideratë numrin e gjyqtarëve që kërkohen të caktohen për secilën çështje, formimi më herët i trupave gjykues për çështjet në nevojë për caktim gjyqtari si edhe për ekonomizim të burimeve njerëzore, referuar pikë VI, Kreu VII të Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, për hapat e shortit që duhet të ndiqen, Komisioni propozon: Për çështjen nr.1, për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, ai të përzgjidhet me short midis gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, ndërsa në përbërje të trupit gjykues për këtë çështje ka gjyqtarë të kësaj gjykate.

Për çështjen nr.3, për të cilën kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve, ata të përzgjidhen, me short, midis gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Gjirokastër.

Për çështjet nr.2 dhe nr.4, për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari, për secilën nga ato, ai të përzgjidhet me short midis gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Gjirokastër të caktuar për çështjen nr.3. Në këtë rast, gjyqtari i përzgjedhur për çështjen e përzgjedhur e para, përjashtohet nga shorti për çështjen tjetër.

Kemi të njëjtin propozim për përjashtim nga shorti, për kryetaren, zëvendëskryetaren e Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, zonjën {...} si dhe për kryetarin e Gjykatës së Apelit Gjirokastër, zotin {...}.

Jeni dakord?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Dakord.

Mirë atëherë, vijojmë procedurat e shortit. Fillimisht për çështjen nr. 1 për të cilën kërkohet caktimi i 1 gjyqtari. Do të hedhim në një enë emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, duke përjashtuar gjyqtaren {...} e cila ka pengesë për këtë çështje, mbasi është e caktuar më herët. Duhet të hedhim emrat e gjyqtarëve të tjerë. Janë: {...}, {...}, {...} dhe {...}. Do të përzgjedhim njërin prej tyre.

{...}, është emri i përzgjedhur.

Vazhdojmë për çështjen nr. 3 për të cilën kërkohet caktimi i 2 gjyqtarëve, që do të përzgjidhen nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Gjirokastër. Do të hedhim në një enë emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, që janë: {...} ... {...}. Do të përzgjedhim dy prej tyre që caktohen për çështjen nr. 3.

Emri i parë është {...} dhe emri i dytë është {...}.

Për çështjen nr. 2 dhe 4 do të bëjmë short midis gjyqtarëve të përzgjedhur për çështjen nr. 3, pra mes gjyqtarëve {...} dhe {...}. Do t'i hedhim në një enë emrat e tyre. Në enën tjetër do hedhim numrat 2 dhe 4.

Do përzgjedhim çështjen e parë. Ka numrin 4.

Do të përzgjedhim emrin e gjyqtarit – është {...}.

Kështu që për çështjen nr. 2, mbetet gjyqtarja {...}.

Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Apelit Vlorë.

Vijojmë me **Gjykatën e Apelit Durrës**. Gjykata e Apelit Durrës ka paraqitur nevojë vetëm për 1 çështje, që është në lëndë penale. Kërkohet caktimi i 1 gjyqtari.

Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit ndërsa është i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm, duke qenë kështu i aplikueshëm vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, referuar të cilit Komisioni propozon që gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1. Ky propozim është bërë referuar faktit të përbërjes së trupit gjykues që është ngarkuar për gjykimin e kësaj çështjeje. Propozimi i vetëm për përjashtim është për t'u

përrjashtuar zonja {...} si dhe për t'u përrjashtuar gjyqtarët e Gjykatës së Apelit për krimet e rënda që u caktuan në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë.

Jeni dakord?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Dakord.

Atëherë, duke hequr zonjën {...} dhe tre gjyqtarët e Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda që u caktuan në Gjirokastrë, që ishin {...}, {...} dhe {...}, mbetet gjyqtari {...} dhe {...}, që duhet të bëjmë short midis tyre që të caktohet në Gjykatën e Apelit Durrës.

Është {...}.

Me kaq mbyllet procedura e shortit për Gjykatën e Apelit Durrës.

Dhe vijojmë me relacionin e fundit që është për **Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda**. Ka paraqitur nevojën në 1 çështje. Kërkoheft caktimi i 1 gjyqtari.

Edhe në këtë rast është i pazbatueshëm mekanizmi i skemës së delegimit si dhe i padobishëm zbatimi i mekanizmit të transferimit të përrkohshëm, duke qenë i aplikueshëm vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor "Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përrhershme", referuar të cilit Komisioni ka propozuar që gjykata nga duhet të përrzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Apelit Tiranë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1 dhe ky të jetë nga Seksioni Penal i Gjykatës së Apelit Tiranë.

Në këtë rast kemi propozuar përrjashtim nga shorti të dy gjyqtarëve që kanë paraqitur tashmë kërkesë për heqje dorë nga statusi i magjistratit, zoti {...} dhe zoti {...}. Të përrjashtohen po ashtu nga shorti edhe gjyqtarët e Seksionit Penal në Gjykatën e Apelit Tiranë që u caktuan për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Apelit Korçë, që ishin më herët gjyqtarët {...}, {...} dhe... Emri i tretë që u çua në Korçë, kush ishte?

{...}, {...} dhe {...}.

Pra të përrjashtohen këta 5 gjyqtarë: {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}.

Jeni dakord?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Dakord.

Fusim në një enë emrat e gjyqtarëve të tjerë që kanë mbetur. Është {...}, {...}, {...} dhe {...}. Do të përzgjedhim njërin prej tyre.

Emri i përzgjedhur është {...}.

Me kaq mbyllen procedurat e shortit për Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda dhe të gjithë shortet. Faleminderit!

*Naureda Llagami*: Shumë faleminderit!

\* \* \*

(Pika 6 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**